



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 171

Tiranë – E enjte, 25 shtator 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 22, datë 15.9.2025	Për përcaktimin e metodologjisë së përgatitjes së studimit të plotë të fizibilitetit dhe studimit të thjeshtuar të fizibilitetit..... 21839
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 898, datë 18.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Malit të Zi..... 21864
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 907, datë 19.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë..... 21865
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 908, datë 19.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Estonisë..... 21867
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 909, datë 19.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë..... 21870
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 794/8, datë 18.9.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 206, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore, Nyja e Milotit’” 21872
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 226/11, datë 22.9.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i terreneve sportive dhe muri rrethues për shkollën ‘Mustafa Greblleshi’ dhe ‘Sandër Prosi’” 21873
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nr. 41-2024-1253 (319), datë 15.4.2025	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Arqile Kristaq Bacu..... 21877

**UDHËZIM****Nr. 22, datë 15.9.2025**

**PËR PËRCAKTIMIN E
METODOLOGJISË SË PËRGATITJES
SË STUDIMIT TË PLOTË TË
FIZIBILITETIT DHE STUDIMIT TË
THJESHTUAR TË FIZIBILITETIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pikën 8, shkronja “F”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Çdo propozim për projekt investimesh publike, që ka vlerë të plotë mbi kufirin e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave, për t'u përfshirë në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, duhet të shoqërohet me studimin e plotë të fizibilitetit, i cili përgatitet sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Çdo propozim për projekt investimesh publike, që ka vlerë të plotë brenda kufijve financiarë të përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave, duhet të shoqërohet me studimin e thjeshtuar të fizibilitetit, i cili përgatitet sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, përpara procesit të buxhetimit.

3. Cilësia e konceptimit dhe e përmbajtjes së dokumentit të Studimit të Plotë të Fizibilitetit dhe Studimit të Thjeshtuar të Fizibilitetit të projektit është përgjegjësia përfundimtare e propozuesve të projektit.

4. Përmbajtja e dokumenteve të studimit të fizibilitetit dhe mënyra e përgatitjes të këtij informacioni bëhet sipas metodologjisë në shtojcat bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Bazuar në natyrën e projektit, institucioni propozues, duke argumentuar, mund të vlerësojë si të paaplikueshme një apo disa seksione të metodologjisë në shtojcat 1 dhe 2 bashkëlidhur.

6. Bazuar në kërkesat specifike të projekteve, apo kërkesat e donatorëve dhe financuesve ndërkombëtarë, institucionet propozuese mund të përfshijnë

seksione shtesë në Studimet e Fizibilitetit për të adresuar aspektet specifike të kërkuara.

7. Dokumenti i Studimit të Plotë të Fizibilitetit, si dhe dokumenti i Studimit të Thjeshtuar të Fizibilitetit përgatiten nga institucioni propozues me burime të brendshme ose nëpërmjet kontraktimit të subjekteve private të licencuara apo enteve publike dhe/ose akademike të specializuara.

8. Dokumenti i Studimit të Plotë të Fizibilitetit, si dhe dokumenti i Thjeshtuar i Studimit të Fizibilitetit duhet të dorëzohen për vlerësim në gjuhën shqipe, të hartuar në përputhje me normat gjuhësore dhe teknike të Republikës së Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCIVE
Petrit Malaj

**SHTOJCA 1
STUDIMI I PLOTË I FIZIBILITETIT**

TABELA E PËRMBAJTJES**Hyrje****1. Përmbledhja ekzekutive****2. Analiza e kontekstit ekzistues****2.1 Rishikimi i kontekstit social dhe ekonomik****2.2 Politika dhe strategjia e qeverisë/masterplani për sektorin/nënsektorin****2.3 Rolet dhe përgjegjësitë në sektor/nënsektor****2.4 Analiza e kapaciteteve institucionale****3. Nevojat dhe objektivat e projektit****3.1 Analiza e nevojave dhe identifikimi i përdoruesve të synuar****3.2 Objektivat e projektit me treguesit****4. Analiza e kërkesës****5. Analiza e opsioneve****6. Studimet teknike****6.1 Sondazhet në terren****6.2 Rishikimi i çështjeve të planifikimit hapësinor****6.3 Marrja e tokës****6.4 Projekti teknik paraprak****7. Objekti përfundimtar i projektit****8. Kostot financiare të projektit dhe plani i zbatimit të projektit****8.1 Vlerësimi i kostove financiare të projektit****8.2 Plani i zbatimit të projektit****9. Analiza financiare****9.1 Metodatat dhe supozimet**



9.2 Vlerësimet e kostove të investimeve financiare, kostove operative dhe të ardhurave gjatë kohëzgjatjes së projektit

9.3 Financimi i projektit

9.4 Përballueshmëria e buxhetit

9.5 Analiza financiare e fluksit monetar

10. Analiza ekonomike

10.1 Metodat dhe supozimet

10.2 Vlerësimi i kostove dhe i përfitimeve, duke përfshirë emetimet e gazeve serrë (GHG)

10.3 Vlerësimi i efekteve që nuk kapen nga vlerësimi ekonomik

10.4 Analiza e kosto-përfitimit dhe performanca ekonomike

11. Analiza e vlerës për para për partneritetet publike private

11.1 Qasja metodologjike

11.2 Analiza cilësore e vlerës për para

11.3 Analiza sasiore e vlerës për para

12. Ndikimet mjedisore dhe sociale

12.1 Ndikimi në mjedis, duke marrë parasysh përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike

12.2 Ndikimi social

13. Zbatimi dhe qëndrueshmëria operationale

13.1 Aftësitë e subjekteve zbatuese dhe operuese

13.2 Pasqyrë e përgjithshme e përgatitjeve të menaxhimit të projektit

14. Analiza e riskut dhe e sensitivitetit

14.1 Burimet kryesore të riskut dhe ndikimet e tyre të mundshme, masat reduktuese

14.2 Vlerësimi i riskut të ndryshimeve klimatike me masa reduktuese

14.3 Plani i menaxhimit të riskut

14.4 Analiza e sensitivitetit

15. Konkluzione mbi fizibilitetin e Projektit

Fjalori

Hyrje

Në këto udhëzime për përgatitjen e studimit të plotë të fizibilitetit jepen këshilla të detajuara për njësitë e qeverisjes qendrore, lidhur me pritshmëritë dhe kërkesat në lidhje me përmbajtjen dhe cilësinë e studimeve të fizibilitetit. Këto studime përgatiten me qëllim të vlerësimit të projekteve investuese në kuadër të procesit të Menaxhimit të Investimeve Publike në Shqipëri. Njësitë e Qeverisjes Qendrore, përgjegjëse për propozimin dhe realizimin e projektit, mbajnë përgjegjësi të plotë për kryerjen e vlerësimeve të detajuara dhe të sakta të projekteve që propozojnë.

Faqe | 21840

Subjekti përgjegjës për projektin ka detyrën të përgatisë studimin e fizibilitetit referuar punës projektuese paraprake dhe studimeve mbështetëse, si p.sh., studime të ndikimit mjedisor, social apo studime të tjera specifike, sipas natyrës së projektit. Kjo punë mund të realizohet nga stafi i brendshëm i institucionit propozues, ose nëpërmjet kontraktimit të firmave private të konsulencës, ekspertëve të pavarur ose institucioneve akademike dhe kërkimore të specializuara.

Udhëzimet e mëposhtme përcaktojnë përmbajtjen minimale dhe kërkesat e domosdoshme për një studim të plotë fizibiliteti në Shqipëri, duke pasqyruar praktikën më të mira ndërkombëtare. Dokumenti është kryesisht i bazuar në Udhëzuesin e Komisionit Evropian për Analizën Kosto-Përfitim të Projekteve të Investimeve, 2014, dhe përfshin udhëzime të detajuara për sektorë të ndryshëm, përfshirë transportin, mjedisin, energjinë, brezin e gjerë etj. Për më tepër, përmbajtja e këtij udhëzimi është harmonizuar edhe me Udhëzuesin e Referencës për Investimet Publike të Bankës Botërore, 2020, për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të standardizuar.

Struktura e studimit të fizibilitetit nuk nënkupton një renditje strikte të punës apo një proces linear. Përkundrazi, realizimi i studimit përfshin faza reagimi, verifikimi dhe përsëritjeje midis elementeve të ndryshme, ku rezultatet dhe konkluzionet përmirësohen gradualisht. Studimi përfundimtar i fizibilitetit është produkt i këtyre ndërveprimeve dhe jo thjesht një renditje e thjeshtë e analizave.

Ky dokument synon të sigurojë një udhëzues të qartë dhe praktik për përgatitjen e studimeve të plota të fizibilitetit, që janë thelbësore për një vlerësim të saktë dhe të besueshëm të projekteve investuese publike në Shqipëri.

1. Përmbledhja ekzekutive

Përmbledhja ekzekutive e studimit të fizibilitetit jepet për t'u lejuar vendimmarrësve akses të lehtë në të dhënat përkatëse. Është thelbësore që ky kapitull të plotësohet kur të gjitha seksionet e tjera të jenë finalizuar.

Përmbajtja e këtij kapitulli duhet të përbëhet nga informacioni më i rëndësishëm në lidhje me projektin, subjekti i projektit dhe objekti i përgjithshëm i aktiviteteve dhe përfshin të paktën, sa vijon:

- Titullin e projektit;
- Sektorin e projektit;



- Vendndodhjen e projektit;
- Deklaratën e problemit/mundësisë që Projekti do të zgjidhë/trajtojë;
- Objektivat e projektit;
- Përshkrimin e një zone të ndikuar nga projekti dhe rezultatet e analizës së kërkesës;
- Përshkrimin e objektit të projektit dhe kostos së investimeve;
- Planin e zbatimit të projektit;
- Përmbledhjen dhe rezultatet e analizave financiare dhe ekonomike;
- Prezantimin e masave të zbatimit;
- Qëndrueshmërinë e projektit;
- Rekomandimet.

2. Analiza e kontekstit ekzistues

2.1 Rishikimi i kontekstit social dhe ekonomik

Hapi i parë i vlerësimit të projektit ka si qëllim të kuptohet konteksti social, ekonomik dhe institucional në të cilin do të zbatohet projekti. Në të vërtetë, mundësia e arritjes së parashikimeve të besueshme të përfitimeve dhe kostove, shpesh mbështetet në saktësinë në vlerësimin e kushteve makroekonomike dhe sociale në zonën e ndikimit të projektit. Në varësi të projektit, kufijtë e kontekstit përkatës të kësaj analize, p.sh. lokale, kombëtare ose ndërkombëtare, duhet të identifikohen rast pas rasti. Një analizë e thellë e kontekstit social-ekonomik është, gjithashtu, e dobishme për kryerjen e analizës së kërkesës.

Në këtë kapitull të studimit të fizibilitetit do të jepet informacion i përgjithshëm mbi rajonin përkatës në të cilin do të zbatohet projekti (*aspektet territoriale dhe mjedisore, të dhënat bazë demografike, ekonomike, financiare, sociale etj.*). Ky informacion duhet të jetë i rëndësishëm për objektin e investimeve.

2.2 Politika dhe strategjia e qeverisë/masterplani për sektorin/nënsektorin

Kërkohet përshkrimi i një projekti, në kontekstin e përputhshmërisë së tij me politikat ose strategjitë përkatëse të qeverisë. Një përshkrim i tillë duhet të provojë se projekti po ndiqet në interes të plotësisë së nevojave të zhvillimit ekonomik ose social të kombëtar, ose të një zone lokale. Duhet të shtjellet mënyra se si projekti kontribuon në arritjen e një ose më shumë objektivave të zhvillimit të vendit dhe sektorit.

2.3 Rolet dhe përgjegjësitë në sektor/nënsektor

Duhet të jepet një përshkrim i projektit në kuadrin e rregullimeve organizative në sektorin përkatës. Informacioni duhet të paraqesë situatën aktuale të një sektori përkatës në Shqipëri, si dhe të gjithë informacionin që lidhet me sistemin në të cilin do të funksionojë projekti. Ky kapitull duhet t'u përgjigjet kryesisht pyetjeve të mëposhtme:

-Cila është situata aktuale e sektorit (paraqitja dhe analiza e tendencave të fundit, informacion i përgjithshëm i sektorit) në të cilin do të operojë projekti?

- Cila është situata, si dhe struktura organizative e sistemit, në të cilin do të operojë projekti?

2.4 Analiza e kapaciteteve institucionale

Kapaciteti institucional u referohet të gjitha rregullimeve institucionale të nevojshme për zbatimin dhe funksionimin e projektit [p.sh., krijimi i një Njësie për Zbatimin e Projektit (NJZP)], duke përfshirë çështjet ligjore dhe kontraktuale.

Në këtë seksion duhet të jepet një prezantim i zgjidhjeve të mundshme institucionale dhe të tregohet opsioni më efektiv, me arsyetim.

Kur pronari i infrastrukturës dhe operatori i saj janë të ndryshëm, duhet të jepet një përshkrim mbi pronarin dhe mbi kompaninë ose agjencinë operuese që do të menaxhojë infrastrukturën (nëse dihet). Kjo duhet të përfshijë statusin ligjor të subjektit operues, kriteret e përdorura për përzgjedhjen e tij dhe marrëveshjet kontraktuale të parashikuara ndërmjet partnerëve, duke përfshirë mekanizmat e financimit (p.sh., mbledhjen e tarifave/pagesave të shërbimit, praninë e subvencioneve qeveritare).

3. Nevojat dhe objektivat e projektit

3.1 Analiza e nevojave dhe identifikimi i përdoruesve të synuar

Kërkohet një përshkrim i kushteve që krijojnë nevojën për të zbatuar projektin, d.m.th., arsyetimin e projektit.

Studimi i fizibilitetit duhet të shpjegojë qartë arsyen përse projekti është i nevojshëm, duke identifikuar problemet (ose mundësitë) që do të trajtohen nga projekti. Problemet e identifikuar duhet të përshkruhen në lidhje me përfituesit e projektit dhe nëse është e aplikueshme të mbështeten me të dhëna përkatëse. Përmbajtja e këtij seksioni duhet të identifikojë qartë dhe të



dallojë përdoruesit (përfituesit) e synuar, sipas llojit (p.sh., shoferë, fëmijë shkolle, familje etj.).

3.2 Objektivat e projektit me treguesit

Pika fillestare për kryerjen e analizave në lidhje me legjitimitetin e zbatimit të aktiviteteve investuese dhe qëndrueshmërinë e tyre ekonomike është përcaktimi i objektiveve të projektit. Objektivat e projektit duhet të përcaktohen mbi bazën e një analize të nevojave të mjedisit social dhe ekonomik në lidhje me shkallën e projektit.

Objektivat duhet të jenë SMART – që do të thotë specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe të kufizuara në kohë. Kjo është për të mundësuar monitorimin e projektit gjatë kohëzgjatjes së tij, për të vlerësuar nëse dhe në çfarë mase ai po i arrin objektivat e tij dhe më vonë për të mundësuar vlerësimin e projektit për të parë në çfarë shkalle projekti ka qenë i suksesshëm ose jo.

Objektivat e matshëm të Projektit duhet të pasqyrohen në *output*-e dhe në treguesit e rezultateve.

Treguesit e outputeve përshkruajnë shpërndarjen e produkteve, p.sh., kilometra rrugë të ndërtuara, kapacitetin e rezervuarëve mbajtës (m^3) të krijuar, numrin e shkollave të rinovuara etj. Arritja e rezultateve të projektit nuk ofron garanci se projekti do të jetë i suksesshëm, por pa arritjen e rezultateve mundësitë për sukses mund të jenë të pakta.

Treguesit e rezultateve shprehen në termat e arritjes së përfitimeve të qëndrueshme për përfituesit e projektit, p.sh., më shumë studentë që hyjnë në universitet ose përdorin njohuritë, si dhe ulja e sëmundshmërisë së fëmijëve nga sëmundje të caktuara.

Në këtë kapitull pritet, gjithashtu, të jepet një përshkrim i ndikimit të projektit, i cili duhet kuptuar si objektiv i përgjithshëm në të cilin projekti do të kontribuojë, të tilla si rritja e të ardhurave, përmirësimi i standardeve të jetesës, përmirësimi i atraktivitetit për turizmin dhe mbrojtja e burimeve natyrore.

4. Analiza e kërkesës

Analiza e kërkesës identifikon dhe përcakton sasinë e nevojës sociale për investimin e planifikuar. Analiza rigoroze e kërkesës është në qendër të një vlerësimi të mirë të projektit dhe është thelbësore për:

- Projektimin e aseteve kapitale me madhësi të përshtatshme, me kapacitetin e nevojshëm për përdoruesit aktual dhe të ardhshëm;

- Përgatitjen e llogaritjeve të besueshme të kostos;

- Vlerësimin e saktë të përfitimeve të projektit; dhe

- Arritjen e një përfundimi të fortë mbi qëndrueshmërinë ekonomike të projektit.

Zhvillimi i një parashikimi sasior të kërkesës së pritshme për shërbimet e përcaktuara të projektit, duke përfshirë rritjen e pritshme të kësaj kërkesë gjatë kohëzgjatjes së projektit, është thelbësor gjatë vlerësimit të projektit. Në varësi të natyrës së projektit, këto parashikime mund të mbulojnë elemente të tilla, si: regjistrimin në shkollë, ngarkesën në spitale, trafikun rrugor, konsumin e ujit dhe prodhimin e mjetëve të ngurta.

Kërkesa ndikohet nga një numër faktorësh të cilët, në varësi të rëndësisë së tyre, mund të duhet të merren parasysh kur bëhen parashikime. Këtu përfshihet:

- Informacioni mbi rritjen ekonomike;

- Ndryshimet e të ardhurave midis përdoruesve potencialë të synuar;

- Ndryshimi demografik – rritja ose rënia natyrore e popullsisë dhe të grupeve të ndryshme brenda saj, migrimi brenda ose jashtë zonës së projektit;

- Zhvillimet e reja të industrisë, biznesit ose bujqësisë në zonën e projektit;

- Kostoja e shërbimeve të ofruara (edhe nëse janë falas, mund të ketë kosto të përfshira në aksesin e shërbimeve);

- Ndryshimi teknologjik afatgjatë dhe ndryshimet në preferencat e publikut.

Niveli i detajeve në parashikimet e kërkesës mund të ndryshojë në varësi të shkallës së projektit dhe masës për të cilën ai është inovativ. Për projektet madhore ose shumë inovative, analiza e kërkesës pritet të jetë shumë e detajuar, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave parësore nëpërmjet sondazheve dhe përdorimin e analizave ekonometrike dhe, aty ku është e zbatueshme, teknikave të modelimit. Për projekte të drejtpërdrejta dhe me vlerë më të ulët, qasja mund të jetë më e thjeshtë, bazuar në analizën inteligjente të tendencës. Megjithatë, thjesht ekstrapolimi i tendencave aktuale, pa diskutim nuk është i pranueshëm. Tendencat duhet të shqyrtohen në mënyrë kritike, për të siguruar që nuk do të ketë ndryshime të rëndësishme në faktorët themelorë gjatë kohëzgjatjes së projektit. Cilado qasje, që



përdoret për përgatitjen e kërkesës, është e rëndësishme të paraqiten dëshmi historike të tendencave të mëparshme, ku kjo ekziston, për të vendosur parashikimin në kontekst.

Për shkak të ndryshimeve në nxitësit themelore të kërkesës, parashikimet më të sakta do të merren duke projektuar veçmas kërkesën për grupe të ndryshme përdoruesish (dhe më pas duke i kombinuar ato), në vend që të zhvillohen parashikime të përgjithshme, p.sh., ndryshimet në rritjen e kërkesës për udhëtime biznesi dhe argëtimi ose për ujë, sipas llojit të përdoruesit (industrial, të biznesit, institucional ose rezidencial).

5. Analiza e opsioneve

Përse kemi nevojë për analizën e opsioneve?

Qëllimi i analizës së opsioneve është të krahasohen dhe të vlerësohen zgjidhjet e mundshme joinvestimi ose investimi¹. Qëllimi i analizës së opsioneve është të përcaktojë se cila nga këto zgjidhje është më e dobishme dhe duhet zgjedhur për zbatimin e projektit. Analiza e opsioneve është një nga analizat më të vështira, por në të njëjtën kohë një nga analizat më të rëndësishme në përgatitjen e projektit.

Gjatë përgatitjes së projektit, duke qenë se mbledhet më shumë informacion për nevojat, mjedisin e projektit dhe zgjidhjet e mundshme, lista e opsioneve mund të ndryshojë. Mund të ketë pasur disa opsione që janë refuzuar për ndonjë arsye në fazat e mëparshme. Duhet që ato të përmenden në studim fizibiliteti dhe të tregohen arsyet e rëndësishme se përse analizat e tyre të mëtejshme janë braktisur. Kjo do të tregojë se kontraktori/promovuesi i projektit ka marrë në konsideratë një numër zgjidhjesh alternative dhe nuk ka lënë jashtë asnjë zgjidhje të rëndësishme.

Në fund të fundit, duhet të krahasohen opsionet që janë të realizueshme dhe çojnë në zgjidhjen e problemit të identifikuar në kapitullin 3, “Nevojat dhe objektivat e projektit”. Nëse ka shumë opsione të mundshme, veçanërisht në projekte më të mëdha, duhet të merret parasysh një studim paraprak fizibiliteti, në mënyrë që të kufizohet numri i

zgjidhjeve që do të merren parasysh në fazën përfundimtare.

Gjatë përcaktimit të zgjidhjeve alternative, është thelbësore t'i referohemi gjithashtu një opsioni “biznes si zakonisht” (varianti 0), ndaj të cilit projekti dhe opsionet e listës së ngushtë do të krahasohen. Megjithatë, ky variant 0 nuk mund të konsiderohet një opsion, pasi nuk çon në zgjidhjen e problemit që është identifikuar. Duhet mbajtur parasysh që të krahasohen opsionet që çojnë në rezultate të ngjashme, në drejtim të përgjigjes ndaj një nevojë të identifikuar dhe zgjidhjes së problemit kryesor.

Metodat për krahasimin e opsioneve

Në thelb, ekzistojnë tri metoda më të zakonshme të krahasimit të opsioneve:

- Analiza me shumë kritere (MCA)
- Analiza e kosto-efektivitetit (CEA)
- Analiza kosto-përfitim (CBA).

MCA-ja është më e lehta për t'u përdorur, ku një sistem me kritere dhe rëndësi përdoret për të vlerësuar opsionet individuale, duke u caktuar atyre pikë. Metoda CEA krahason kostot gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit me rezultatet e arritura (p.sh. sa kushton mesatarisht për të trajtuar 1 m³ ujëra të zeza komunale gjatë 30 vjetëve) dhe zgjedh opsionin me kosto më efektive. Metoda më komplekse dhe më e kërkuar është CBA e plotë, ku kostot dhe përfitimet vlerësohen për opsionet individuale dhe llogariten treguesit e efikasitetit ekonomik. Mund të ndodhë që në një rast të caktuar të përdoret më shumë se një metodë.

Më shumë informacion mbi MCA-në dhe CEA-në jepet në udhëzimet e KE-së (*shtojka IX, “Mjete tjera vlerësimi”*). CBA-ja është përshkruar gjerësisht në udhëzimet e KE-së.

Cilat opsione mund të merren parasysh?

Parashikohet që opsione të ndryshme investimi (dhe joinvestimi) mund të merren parasysh në analizë, në varësi të karakteristikave të projektit:

- Analiza e opsioneve të mundshme të vendndodhjes së projektit, me qëllim përcaktimin e vendndodhjes më të mirë për projektin². Kjo do të jetë e rëndësishme, për shembull, në rastin e objekteve të mbetjeve të ngurta, impianteve të

¹ Analiza e opsioneve synon të identifikojë zgjidhjen e preferuar. Ajo jep përgjigje për një pyetje të rendit të parë. Pasi të identifikohet zgjidhja e preferuar, mund të kërkohej analizë e mëtejshme e varianteve teknike. Për shembull, në një projekt për rrugë, zgjedhja e korridorit ose e një rruge të re kundrejt një zgjidhjeje të ndryshme investimi ose joinvestimi do të konsiderohej në analizën e opsioneve. Ndryshimet në shtrirjen vertikale dhe

horizontale të zgjidhjes së preferuar do të konsideroheshin si variante teknike. Zgjedhja e variantit teknik është një pyetje e rendit të dytë.

² Në shumicën e rasteve vendndodhja duhet të përcaktohet në një fazë më të hershme (planifikimi strategjik/master planifikim). Më pas FS-ja duhet të shpjegojë vetëm arsyet e vendimit që tashmë është marrë.



trajtimit të ujërave të zeza, objekteve sportive, rrugëve të reja më të mëdha (të ashtuquajturat “studim korridor”). Krahassimi i opsioneve të ndryshme të vendndodhjes duhet të marrë parasysh rreziqet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe disa çështje të tjera të rëndësishme për projektin, të tilla si pronësia e tokës dhe aksesit në terren ose çështjet e planifikimit hapësinor.

- Qasja strategjike mbi mënyrën e trajtimit të problemit p.sh. rinovimi i objekteve publike ekzistuese në vend që të ndërtohen të reja.

- Përdorimi i qasjeve të ndryshme teknologjike ose teknologjive të ndryshme. Kjo mund të ndryshojë balancën ndërmjet shpenzimeve kapitale dhe periodike, si p.sh. duke zgjedhur ndërmjet ofrimit të shërbimeve pak a shumë intensive kapitale.

- Përmirësimi i zbatimit të masave ose iniciativave ekzistuese në vend të investimit (p.sh. ndërtimi i një rruge të re nuk është mënyra e vetme për të reduktuar kostot e udhëtimit dhe për të përmirësuar sigurinë. Ka mënyra të tjera për të arritur këto rezultate, të tilla si përmirësimi i menaxhimit të trafikut, tarifimi i mbipopullimit/dyndje dhe instalimi i kamerave të shpejtësisë. Disa nga këto opsione nuk do të kenë nevojë për investime kapitale).

- Ndryshimi i kohës, fazave dhe shkallës të investimit kapital (p.sh. duke bërë fillimisht një objekt më të vogël dhe duke e zgjeruar atë kur kërkesa arrin nivele më të larta).

- Zgjidhje të ndryshme institucionale. Opsionet e projektit mund të përfshijnë masa të tjera, përveç shpenzimeve për asetet e reja kapitale të sektorit publik dhe ofrimin e drejtpërdrejtë publik të shërbimeve, të tilla si përmirësimi i kontrollit rregullator ose subvencionet për ofruesit e shërbimeve të sektorit privat.

Në kapitullin ku trajtohet analiza e opsioneve nuk sugjerohet në asnjë mënyrë një renditje për këtë punë. Analiza e opsioneve është një proces përsëritës dhe nuk është një fazë e veçantë dhe e izoluar në përgatitjen e studimit të fizibilitetit. Është e dobishme të kufizohen opsionet sa më shpejt që të jetë e mundur, por kjo nuk duhet të pengojë kalimin te zgjedhjet, nëse informacioni ose analiza e re ka një ndikim. Në kapitullin mbi analizën e opsioneve duhet të përfshihet tërësia e procesit të përcaktimit të opsionit të preferuar.

Paraqitja e rezultateve

Studimi i fizibilitetit duhet të paraqesë logjikën dhe kriteret që përdoren për secilën fazë të analizës. Analiza e opsioneve duhet të përmbajë një përshkrim të sintetizuar të analizës së zgjidhjeve, për të paktën dy alternativa (opsione) për secilin dimension/fazë të analizës të paraqitur më sipër, të vlerësuar sipas kriterëve të përcaktuara qartë, duke përfshirë kriteret e ndryshimit të klimës. Analiza e opsioneve nuk duhet të konsiderohet si një aktivitet më vete, por si pjesë e analizës më të gjerë të kryer në kuadër të analizës ekonomike. Pavarësisht nga metoda e përdorur, në këtë kapitull duhet të përshkruhet logjika dhe një përmbledhje.

Si pasojë e analizës së opsioneve, opsioni i preferuar duhet të paraqitet dhe të arsyetohet tërësisht. Përshkrimi i duhur duhet të tregojë mënyrën se si çështjet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (duke treguar skenarin e ndryshimit dhe llojin e ngjarjeve të analizuar) janë marrë parasysh në analizën e opsioneve, me kusht që vlerësimi i riskut klimaterik të ketë identifikuar një nevojë të tillë.

6. Studimet teknike

6.1 Sondazhet në terren

Çështjet specifike për kantierin e ndërtimit duhet të kenë fokus të konsiderueshëm dhe të përshkruhen në studimin e fizibilitetit. Studimi i fizibilitetit kërkon studime më të detajuara në terren. Do të ishte e vështirë të paraqitej fizibilitet teknik ose vlerësime të besueshme të kostos pa kryer hetime ose prova në terren. Kryerja e sondazheve gjeoteknike, për shembull, shpesh është e nevojshme për të marrë informacion mbi karakteristikat fizike të tokës, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në vlerësimet e kostos së ndërtimit. Në mënyrë të ngjashme, të drejtat e aksesit në kantieret e ndërtimit janë një arsye e zakonshme për vonesat në projekte dhe duhet të analizohen. Ky subjekt duhet të jetë pjesë e vlerësimit teknik, së bashku me një shpjegim mbi mënyrën e kapërcimit të ndonjë problemi ose duhet të ketë një formulim që deklaron se nuk ka probleme në lidhje me aksesin në vend. Sjellja e shërbimit të energjisë elektrike, gazit, ujit, ujërave të zeza dhe të komunikimit në kantier/vend apo edhe rrugë të reja shërbimi janë sfida të zakonshme në shumë projekte. Përsëri, vlerësimi teknik duhet të analizojë disponueshmërinë dhe mjetet me të cilat të gjitha



shërbimet e kërkuara mund të sillen në vendin e projektit.

6.2 Rishikimi i çështjeve të planifikimit hapësinor

Duhet të paraqitet një përshkrim specifik, i mbështetur me harta dhe dokumente të tjera të aplikueshme, përkatëse për vendndodhjen e projektit, duke marrë parasysh dokumentet e mëposhtme³:

- Planin e përgjithshëm kombëtar të territorit (PPKT);
- Planet kombëtare sektoriale, që mbulojnë të gjithë territorin ose pjesërisht;
- Planin e detajuar të zonave me rëndësi kombëtare;
- Planet e zhvillimit rajonal;
- Planin e përgjithshëm vendor të territorit (PPVT);
- Planin e detajuar vendor (PDV);
- Çdo dokument tjetër përkatës.

Përshkrimi duhet të justifikojë që projekti dhe zona përreth janë në përputhje me supozimet dhe kërkesat e të gjitha planeve përkatëse të zhvillimit hapësinor. Nëse dokumentet përkatëse hapësinore përfshijnë zonimin e informuar për klimën, kjo do të nënkuptojë, gjithashtu, reduktimin e rreziqeve të ndryshimeve klimaterike në lidhje me vendndodhjen e projektit.

6.3 Marrja e tokës

Duhet të paraqitet struktura e pronësisë për të gjitha parcelat e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit. Duhet të tregohet, gjithashtu, nëse organi përgjegjës për projektin ka një bazë për blerjen e të gjithë tokës së kërkuar.

Aty ku kërkohet shpronësim, shqyrtimi sa më herët i çështjeve që duhen zgjidhur për zbatimin e projektit, është thelbësorë për zbatimin në kohë të projektit. Do të ketë implikime ligjore, financiare dhe administrative, si dhe konsultime dhe negociata me palët e interesuara. Analizat dhe konsultimet tashmë të kryera duhet të përshkruhen në këtë seksion, të ndjekur nga një plan i qartë i hapave të mëtejshëm. Kostot e kompensimit dhe të zhvendosjes duhet të përfshihen në analizën financiare.

6.4 Projekti teknik paraprak

Çdo projektpropozim duhet të përmbajë një përshkrim të aspekteve të tij teknike. Të gjitha projektet kanë një shkallë të kontributit teknik; herë domethënëse e herë modeste. Bazuar në studimet teknike dhe analizën e opsioneve të përshkruara më sipër, dizajni teknik i përzgjedhur duhet të paraqitet dhe justifikohet. Të gjitha aspektet kryesore dhe komponentët e projektit teknik duhet të përshkruhen këtu, ndërsa informacion më të detajuar duhet të jepet në dokumentet teknike bashkëngjitur.

7. Objekti përfundimtar i projektit

Objekti i projektit, pjesët përbërëse të tij dhe aktivitetet e propozuara, duhet të jenë mjaftueshëm të gjera për të kapur të gjitha shpenzimet e nevojshme për të ofruar rezultatet e projektit dhe për të arritur objektivat e synuar. Përveç zgjidhjes teknike qendrore, qëllimi i projektit zakonisht përfshin të paktën një prej elementeve të mëposhtme:

- Blerjen e pajisjeve;
- Sigurimin e trajnimit të stafit;
- Zhvillimin e sistemit të TI-së;
- Mbikëqyrjen e ndërtimit (nëse planifikohet të prokurohet nga jashtë);
- Fushatën e ndërgjegjësimit social.

Kjo listë nuk është shteruese dhe projekti mund të përfshijë elemente të tjera. Parimi është se objekti i projektit duhet të shtrihet në të gjithë elementet e nevojshme për të ofruar përfitime të qëndrueshme.

8. Kostot financiare të projektit dhe plani i zbatimit të projektit

Ky kapitull synon të ofrojë vlerësim të kostos për secilin nga komponentët e projektit të përcaktuar në kapitullin e mëparshëm dhe planin e zbatimit të projektit.

8.1 Vlerësimi i kostove financiare të projektit

Objekti i projektit mund të përfshijë kategori të ndryshme kostosh, duke përfshirë kostot kapitale të të gjitha aktiveve fikse dhe aktiveve jofikse. Shembuj të kostove tipike kapitale:

- Kostot e zhvillimit, duke përfshirë kostot e stafit dhe të konsulencës dhe tarifat e tjera profesionale;
- Blerjet e tokës dhe ndërtesave;

³ Sipas nenit 15 të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".



- Tarifat për licencat dhe lejet në lidhje me projektin;
- Kostot e përgatitjes së vendit;
- Punimet përkatëse të infrastrukturës (rruga e hyrjes në kantier, lidhjet e shërbimeve);
- Ndërtimin;
- Kostot sociale dhe të zbutjes mjedisore;
- Blerjet e pajisjeve, automjeteve, harduerit dhe softuerit në lidhje me projektin;
- Kostot e instalimit, zbatimit dhe komisionimit;
- Shpenzimet e mbikëqyrjes;
- Kontigjencat;

Kostot duhet të llogariten për të gjitha kategoritë e buxhetit të projektit. Në fazën e studimit të fizibilitetit, vlerësimet e kostos zakonisht duhet të përgatiten nga inxhinierët/ekspertët teknikë mbi bazën e një projekti paraprak të infrastrukturës përkatëse që rezulton në një faturim paraprak të sasive. Vendosja e kostos së këtyre sasive duhet të bazohet në analizën e tregut.

8.2 Plani i zbatimit të projektit

Në planin material dhe financiar duhet të pasqyrohet zbatimi i planifikuar i projektit dhe kostot që lidhen me zbatimin e këtij projekti. Ai duhet të jetë në përputhje me aktivitetet e përshkruara në kapitullin “Objekti i projektit”.

9. Analiza financiare⁴

9.1 Metodatat dhe supozimet

Objekti i analizës financiare të paraqitur në këto udhëzime mund të zgjerohet nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh natyrën dhe/ose strukturën ligjore dhe financiare të projektit.

Në këtë kapitull duhet të paraqiten, përshkruhen dhe justifikohen metodatat dhe të gjitha supozimet e aplikuara për qëllimin e kryerjes së analizës financiare, duke përfshirë supozimet për skenarët makroekonomikë dhe periudhën e zgjedhur të referencës për analizën, si më poshtë:

- Skenarët makroekonomikë;
- Rekomandohet të përgatitet një analizë në terma realë, por tendencat makroekonomike janë të rëndësishme në rast të ndryshimeve në çmimet relative, p.sh., një rritje më e shpejtë e çmimeve të energjisë sesa inflacioni. Gjithashtu, ndryshimet në kurset e këmbimit mund të kenë ndikim në çmimet

e ardhshme të inputeve dhe supozimet e përdorura duhet të shpjegohen.

- Periudha e referencës (afati kohor)

Sektori	Vitet
Hekurudhat	30
Rrugët	25-30
Portet dhe aeroporti	25
Transporti urban	25-30
Furnizimi me ujë dhe kanalizimet	30
Menaxhimi i mbetjeve	25-30
Energjia	15-25
Brezi i gjerë	15-20
Infrastruktura e biznesit	10-15
Sektorë të tjerë	10-15

Burimi: “Udhëzues për analizën kosto-përfitim të projekteve investuese: Mjeti i vlerësimit ekonomik për politikën e kohezionit, 2014–2020”, DG për Politikat Rajonale dhe Urbane, Komisioni Evropian, 2014

Të gjitha supozimet e tjera përkatëse duhet të përcaktohen.

9.2 Vlerësimet e kostove të investimeve financiare, kostove operative dhe të ardhurave gjatë kohëzgjatjes së projektit⁵.

Vlerësimet e kostove totale të investimit të projektit, si dhe kostot operative dhe të ardhurat vjetore (nëse është e aplikueshme) së bashku me bazën e vlerësimit të tyre duhet të paraqiten këtu.

Kostoja totale e investimit të një projekti përbëhet nga:

- kostot fillestare të investimit (vlera e buxhetit të projektit duhet të jetë në përputhje me kapitullin që paraqet vlerësimin e kostos së projektit);
- kostot e zëvendësimit, të cilat lidhen me kostot që ndodhin gjatë afatit kohor të një projekti për zëvendësimin e makinerive dhe/ose pajisjeve, të cilat do të duhet të përfshihen në shpenzimet gjatë fazës operacionale.

Kostot operative përfshijnë të gjitha kostot që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit të ri ose të përmirësuar, që rrjedhin nga projekti. Shembuj të kostove tipike operative:

- Kostot e punës (pagat dhe sigurimet shoqërore);
- Kostot e shërbimeve;
- Lënda djegëse;

⁴ Modeli financiar-ekonomik i përdorur përbën një shtojcë të detyrueshme të studimit të fizibilitetit.

⁵ Në këtë seksion trajtohen kostot financiare të projektit. Kostot ekonomike mund të ndryshojnë dhe kërkojnë Faqe | 21846

rregullime të kostove financiare, siç do të përcaktohet në kapitull 10.



- Materialet;
- Kostot e sigurisë;
- Kostot e mirëmbajtjes (mirëmbajtje ose riparim i vogël i aseteve);
- Shërbimet e zyrës (p.sh. shërbimet *online*, përpunimi i të dhënave);
- Shpenzimet e qirasë dhe të qiradhënies (qiraja e ndërtesave/zyrave, marrja me qira e makinerive);
- Pastrimi.

Të ardhurat e projektit përfshijnë hyrjet e parave për mallrat ose shërbimet e ofruara nga projekti, p.sh.:

- Tarifat direkte për përdorimin e infrastrukturës (taksat e autostradës);
- Shitja ose qiraja e tokës ose ndërtesave (dhënia me qira e zyrave ose klasave);

Vlera e këtyre të ardhurave do të përcaktohet në parashikim nga çmimet e tyre dhe nga sasitë e vlerësuara të mallrave ose shërbimeve të ofruara gjatë viteve të funksionimit⁶.

Vlera e mbetur duhet të përfshihet si e ardhur në vitin e fundit të analizës.

9.3 Financimi i projektit

Në këtë kapitull duhet të jepet një shpjegim të burimeve të financimit që do të përdoren për të mbuluar kostot e investimit (p.sh. buxheti i shtetit – grantet, subvencionet, mbështetje kapitale në nivele të ndryshme qeveritare; kontributi privat sipas PPP-së – dhe kreditë).

9.4 Përballueshmëria e buxhetit

Duhet të përfshihet një analizë buxhetore për të përcaktuar ndikimin neto që një projekt do të ketë në buxhetin publik gjatë fazave të zbatimit dhe funksionimit të një projekti dhe për të ndihmuar në përcaktimin nëse një investim i tillë mund të përballohet nga perspektiva fiskale. Një analizë e plotë e ndikimit buxhetor merr parasysh të gjitha flukset financiare të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta që kanë ndikim në financat publike, jo vetëm ato që prekin njësinë operative të projektit.

9.5 Analiza financiare e fluksit monetar

Analiza financiare (si dhe ajo ekonomike) duhet të kryhet bazuar në një model financiar diferencial, të përgatitur për një projekt, që krahason flukset monetare për njësinë ekonomike në skenarin “me projekt” dhe me ato në skenarin “pa projekt”.

Mënyrat kryesore të paraqitjes së rezultateve të analizës financiare të fluksit monetar janë:

- Vlera aktuale neto financiare e projektit;
- Norma e brendshme financiare e kthimit;

Këtu duhet theksuar se vlerësimi i përfitimit financiar të projekteve publike nuk është një element vendimtar në zbatimin apo braktisjen e tyre. Prandaj, është e pranueshme të merret një vendim për zbatimin e projektit edhe nëse treguesit e përfitimit financiar janë negativë. Konfirmimi përfundimtar i ligjshmërisë së projektit duhet të pasqyrohet në analizën ekonomike.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i analizës financiare është qëndrueshmëria financiare. Projekti është financiarisht i qëndrueshëm, kur rreziku i mbarimit të parave të gatshme në të ardhmen, si gjatë fazës së investimit ashtu edhe gjatë fazës operative, pritet të jetë zero. Kjo do të thotë që analiza duhet të tregojë se si do të mbulohet çdo mungesë financiare, nëse identifikohet ndonjë, në mënyrë që në skenarin “me projekt”. Investitori/ subjekti operativ të ketë bilanc pozitiv në para në fund të çdo viti⁷.

10. Analiza ekonomike

10.1 Metodatat dhe supozimet

Në këtë kapitull duhet të paraqiten, përshkruhen dhe arsyetohen metodatat dhe supozimet e aplikuara për qëllimin e kryerjes së analizave ekonomike.

Analiza e kosto-përfitimit ekonomik është përgatitur nga analiza financiare e fluksit monetar (duke sjellë ndërmend se për shumë projekte të sektorit publik nuk do të ketë hyrje financiare në formën e të ardhurave). Qëllimi kryesor i një analize ekonomike është shqyrtimi i justifikimit për një investim nga këndvështrimi i shoqërisë në tërësi⁸ dhe përcaktimi nëse burimet ekonomike të

⁶ Duhet të theksohet se shumë projekte publike nuk do të prodhojnë të ardhura. Në këto raste, analiza financiare ka më pak rëndësi, por megjithatë mund të ofrojë informacion të rëndësishëm. Ajo do të përcaktojë vlerat financiare të kostove që përdoren më pas në analizat ekonomike (të rregulluara sipas nevojës). Analiza do të tregojë, gjithashtu, se çfarë mbështetje financiare i nevojitet projektit nga fondet publike, për ta bërë atë financiarisht të qëndrueshëm.

Ky aspekt lidhet edhe me çështjen e ndikimit buxhetor të projektit.

⁷ Shihni seksionin 2.7.7 të udhëzimeve të KE-së për më shumë detaje mbi kryerjen e analizës së qëndrueshmërisë financiare.

⁸ Prandaj, analiza ekonomike-kosto-përfitim referohet edhe si “analizë kosto-përfitim social”.




nevojshme për një projekt përdoren mirë, që do të thotë nëse përfitimet e një projekti tejkalojnë koston e burimeve të përdorura në proces. Analiza ekonomike përfshin korrigjimet për shtrembërimet e rëndësishme të tregut dhe vlerësimin e kostove dhe përfitimeve për të cilat çmimet e tregut nuk ekzistojnë. Ka shumë burime të shtrembërimeve të tregut, duke përfshirë:

- tregjet joefikase, ku sektori publik dhe/ose operatorët ushtrojnë tagrat e tyre (p.sh. subvencionet për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, çmimet duke përfshirë një rritje mbi koston marxhinale në rastin e monopolit etj.);
- tarifatat e administruara për shërbimet komunale mund të dështojnë të pasqyrojnë koston oportune të inputeve, për shkak të përballueshmërisë dhe arsyeve të barazisë;
- disa çmime përfshijnë kërkesat fiskale (p.sh. detyrimet në import, akcizat, TVSH-në dhe taksat e tjera indirekte, tatimin mbi të ardhurat mbi pagat etj.);
- për disa efekte nuk ka treg (dhe çmime) (p.sh. reduktimi i ndotjes së ajrit, kursimi i kohës).

Metodologjia e kalimit nga një analizë financiare në atë ekonomike ka hapat kryesorë të mëposhtëm:

- **Korrigjimet fiskale.** Shpesh, në flukset monetare financiare ka zëra që janë vetëm transferta brenda ekonomisë kombëtare dhe nuk përfaqësojnë kosto ekonomike, d.m.th. shfrytëzimin e burimeve. Subvencionet dhe taksat indirekte, p.sh. TVSH-ja, përfaqëson një transferim të tillë dhe duhet të përjashtohet nga analiza ekonomike⁹.

- **Shndërrimi i çmimeve të tregut në çmime ekonomike/hije.** Kjo mund të jetë e nevojshme kur çmimet e tregut nuk pasqyrojnë koston oportune të inputeve dhe outputeve. Outputet shpesh ofrohen falas (ose me një tarifë minimale) kështu që gatishmëria e përdoruesve për të paguar duhet të matet për të vendosur një çmim ekonomik. Nga ana tjetër, çmimet e inputeve mund të shtrembërohen dhe duhet të rregullohen duke përdorur faktorin e konvertimit ose metoda të tjera për t'i përshtatur ato për të pasqyruar koston reale ekonomike të burimeve¹⁰. Hapat e detajuar në lëvizjen nga çmimet e tregut në ato hije janë të ilustruara në figurën e mëposhtme:



Burimi: Udhëzimet e KE-së

⁹ Për më shumë informacion, referojuni udhëzimeve të KE-së (seksioni 2.8.2, “Korrigjimet fiskale”).

¹⁰ Për më shumë informacion, referojuni udhëzimeve të KE-së (seksioni 2.8.3, “Nga çmimet e tregut në hije”) dhe seksionet pasuese për më shumë detaje mbi specifikat).



Përfshirë eksternalitetet. Një eksternalitet është çdo kosto ose përfitim që zbulohet nga projekti drejt palëve të tjera pa kompensim monetar p.sh. eksternalitetet tipike në sektorin e transportit janë kostot për emetimet e zhurmës dhe ndotësve të ajrit ose përfitimet për jopërdoruesit, për shkak të uljes së mbipopullimit/dyndjes në mënyrat ose rrugët alternative të transportit.

Zbritja e flukseve monetare neto dhe llogaritja e treguesve të performancës ekonomike (vlera aktuale ekonomike neto dhe norma e brendshme ekonomike e kthimit): kostot dhe përfitimet e ardhshme duhet të zbriten deri në ditët e sotme (për të dhënë vlerat aktuale), sepse shoqëria e vlerëson konsumin sot më shumë se konsumin nesër.

E njëjta periudhë referimi (horizonti kohor) për analizën ekonomike duhet të jetë, siç zbatohet në analizën financiare. Për llogaritjen e treguesve të analizës ekonomike duhet të përdoret norma e skontimit social. Kjo do të ndryshojë nga norma e skontimit e aplikuar në analizën financiare, e cila duhet të pasqyrojë koston e kapitalit për subjektin në fjalë.

Në përputhje me udhëzimet e KE-së, **norma e skontimit social prej 5%** duhet të përdoret për të gjitha llogaritjet e vlerës aktuale deri në momentin kur një normë e re të lëshohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë¹¹.

10.2 Vlerësimi i kostove dhe përfitimeve, duke përfshirë emetimet e gazeve serrë (GHG)

Ekzistojnë disa rregulla në lidhje me vlerësimin e kostove dhe përfitimeve ekonomike:

- Proporcionaliteti – përpjekjet e bëra për të analizuar kostot dhe përfitimet duhet të jenë proporcionale me madhësinë e një projekti (projektet më të mëdha kërkojnë një analizë më të thelluar).

- Qasja në rritje – kostot dhe përfitimet duhet të vlerësohen duke iu referuar variantit 0 (skenari “pa projekt”).

- Përdorimi i çmimeve në terma realë.

- Qasjet e bazuara në treg – përfitimet e projektit, të cilat shpesh janë të vështira për t’u vlerësuar për shkak të faktit se shumë shërbime publike janë pa pagesë, duhet të vlerësohen bazuar në gatishmërinë

e përdoruesve të mundshëm për të paguar ose gatishmërinë për të pranuar.

Gatishmëria për të paguar është një pagesë maksimale nga e cila një përfitues do të ishte i gatshëm të hiqte dorë që të merrte një shërbim publik. Në mënyrë të ngjashme, gatishmëria për të pranuar llogaritet për përfitimet dhe përfaqëson pagesën minimale që dikush do të pranojë për të jetuar me një shqetësim, si p.sh., rritje e ndotjes akustike. Gatishmëria e përdoruesve të mundshëm për të paguar ose gatishmëria për të pranuar mund të vlerësohen duke përdorur preferencat e zbuluara (të preferuara dhe më pak sfiduese teknikisht) dhe preferencat e deklaruara (kur preferencat e zbuluara nuk janë të mundshme). Qasja e deklaruar e preferencave kërkon këshilla të ekspertëve për të hartuar dhe interpretuar sondazhet. Duhet të nënvizohet se metoda duhet të përdoret kur përfitimi/kostoja është thelbësore për vendimin dhe analiza e sensitivitetit duhet të zbatohet gjithmonë për rezultatet¹².

Kostot dhe përfitimet e identifikuara duhet të paraqiten dhe përshkruhen në këtë pikë, së bashku me vlerësimin e tyre në terma parash.

Në terma ndërkombëtarë, një kosto e konsiderueshme (dhe ndonjëherë përfitim) e një projekti është rritja/ulja e emetimeve të gazeve serrë. Ndikimi i gazrave serrë është global, afatgjatë dhe u nënshtrohet angazhimeve ndërkombëtare, prandaj duhet të konsiderohet me kujdes në dokumentacion. Në analizë duhet të paraqitet masa e vëllimit të emetimeve të emetuara ose të kursyera shtesë në atmosferë për shkak të projektit. Hapi tjetër është vlerësimi i eksternalitetit, duke përdorur një kosto për njësi të ekuivalentit të CO₂¹³.

10.3 Vlerësimi i efekteve që nuk kapen nga vlerësimi ekonomik

Jo të gjitha përfitimet mund të vlerësohen në terma monetarë. Ato kosto dhe përfitime, të cilat nuk mund të ishin vlerësuar në terma parash, duhet të paraqiten dhe të përshkruhen në këtë kapitull. Ku është e mundur, këto kosto dhe përfitime duhet të shprehen në sasi fizike. Supozimet e bëra në tregues duhet të jenë transparente në mënyrë që të mund të kontrollohen dhe (nëse është e nevojshme) të kundërshtohen nga vlerësuesit.

¹¹ Udhëzimet e KE-së lejojnë që vendet të vlerësojnë normat e tyre të skontimit social, me kusht që përdorimi i parametrave specifike të vendit mund të justifikohet siç duhet.

¹² Për detaje shihni: Seksionet 2.8.6 dhe 2.8.7 të udhëzimeve KE-së.

¹³ Për detaje shihni: Seksionin 2.8.8 të udhëzimeve të KE-së, vlerësimi i emetimeve të GHG-së.



10.4 Analiza e kosto-përfitimit dhe performanca ekonomike

Pasi të gjitha kostot dhe përfitimet e projektit janë llogaritur dhe vlerësuar në terma monetarë, është e mundur të matet performanca ekonomike e projektit, duke llogaritur treguesit e mëposhtëm:

Vlera aktuale ekonomike neto është diferenca ndërmjet përfitimeve totale sociale të skontuara dhe kostove.

Norma e brendshme ekonomike e kthimit është norma e skontimit, që prodhon një vlerë zero për ENPV-në.

Në parim, çdo projekt me një normë të brendshme ekonomike kthimi më të ulët se norma e skontimit social, ose një vlerë aktuale ekonomike neto negative duhet të refuzohet. Një projekt me një kthim negativ ekonomik përdor shumë burime të vlefshme shoqërore për të arritur përfitime shumë modeste për të gjithë qytetarët.

Zbatimi specifik i analizës ekonomike ndryshon sipas sektorit.

Ndërsa rezultatet e analizës ekonomike duhet të jenë shumë të rëndësishme në informimin e rekomandimeve të studimit të fizibilitetit dhe vendimit të vlerësimit, faktorë të tjerë mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar, duke përfshirë kostot ose përfitimet e rëndësishme që nuk janë monetizuar dhe faktorët e qëndrueshmërisë.

11. Analiza e vlerës për para për partneritetet publike private

11.1 Qasja metodologjike

Ky kapitull zbatohet vetëm për projektet që do të zbatohen sipas modalitetit PPP.

PPP-ja është një modalitet zbatimi që mund të përdoret në projekte publike, kur justifikohet. Analiza që krahason efikasitetin e zbatimit të projektit në formulën PPP në krahasim me formulën tradicionale të zbatimit nga subjekti publik emërtohet analiza “Vlera për paranë”¹⁴.

Analiza e vlerës për para duhet të kryhet për çdo projekt PPP-je, pasi të konfirmohet fizibiliteti i tij (duke përfshirë efektivitetin ekonomik). Qëllimi i tij është t'i përgjigjet pyetjes nëse projekti në shqyrtim duhet të zbatohet duke përdorur PPP-në apo metodën tradicionale. Analiza e vlerës për para duhet të kryhet për projektet që janë treguar si potencialisht të zbatueshme duke përdorur modalitetin PPP në fazën e plotësimit të formularit të konceptimit të projektit të investimit, kur duhet të ishin identifikuar arsyet paraprake për marrjen në konsideratë të kësaj qasjeje.

Analiza e vlerës për para përfshin analizën cilësore dhe analizën sasiore.

11.2 Analiza cilësore e vlerës për para

Analiza cilësore e vlerës për para duhet të marrë parasysh përfitimet që mund të merren nga perspektiva e interesit shoqëror në fushat e mëposhtme:

Tabela 1: Analiza cilësore e vlerës për para

Nr.	Fusha	Pyetje të rëndësishme
1	Shkalla e projektit	- A është shkalla e projektit e mjaftueshme që çdo përmirësim në efektshmëri mund të kompensojë kostot e prokurimit?
2	Koha e nevojshme për të përfunduar projektin	- A do të lejojë përdorimi i modalitetit PPP për zbatimin e projektit zbatim më të shpejtë të projektit? - A do të reduktojë përdorimi i formulës PPP rrezikun e vonësve në krahasim me modelin tradicional?
3	Ndarja e detyrave	- A do të lejojë zbatimin e projektit, duke përdorur modalitetin PPP, ofrimin e infrastrukturës më cilësore në terma afatgjatë krahasuar me modelin tradicional? - A ofrohet rritje e cilësisë së shërbimeve në kuadër të projektit PPP? A mund të ofrohet i njëjti nivel i cilësisë së shërbimit në modelin tradicional? - A ka partneri privat përvojë/ekspertizë më të madhe se partneri publik në ofrimin e shërbimeve? - A janë të nevojshme kompetenca të specializuara për zbatimin e projektit?
4	Ndarja e rreziqeve	- A do të mund partneri privat të menaxhojë më mirë se subjekti publik rreziqet e transferuara në modalitetin PPP?

¹⁴ Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj vlerës për para është paraqitur në vlerësimin e vlerës për para. Rishikimi i qasjeve dhe koncepteve kryesore (mars 2015) në dispozicion në: Faqe | 21850




		- A mund të kalojnë këto rreziqe te kontraktorët në modelin tradicional të zbatimit të investimeve?
5	Kostot e kohëzgjatjes së projektit	- A është projekti relativisht kompleks në mënyrë që partnerët privatë të mund të ofrojnë zgjidhje novatore të projektimit, ndërtimit dhe menaxhimit që së bashku mund të krijojnë sinergji për rritjen e efikasitetit? - A ka potencial për inovacion? A është ndryshe për modelet e zbatimit të investimeve?
6	Tarifat nga përdoruesit dhe palët e treta	- Në modelin PPP, a mundet partneri privat të marrë të ardhura shtesë, duke ulur tarifat e përdoruesve?
7	Profili i shpenzimit të fondeve publike	- A janë identifikuar përfitimet e vendosjes së kostove afatgjata të projektit? - A do të lejojë përdorimi i modelit PPP subjektin publik, për një projekt të caktuar, që të kryejë projekte të tjera falë disponueshmërisë më të madhe të fondeve në afat të shkurtër?
8	Oreksi i tregut	- A ka dëshmi se ka mjaftueshëm partnerë privatë potencialë me oreks dhe kapacitet për të ofruar projektin? - A sugjeron natyra e transaksionit (p.sh. rëndësia e tij strategjike) se ai do të shihet nga tregu si një sipërmarrje fitimprurëse?
9	Aftësia për të përcaktuar dhe monitoruar rezultatet	- A mund të monitorohen lehtësisht rezultatet dhe cilësia e zbatimit të kontratës?
10	Karakteristikë e kërkesës në të ardhmen	- A nuk u nënshtrohet ndryshimeve të shpejta kërkesa për shërbimet e ofruara në kuadër të projektit, për shkak të ndryshimeve në teknologji?

Nëse përgjigjet e pyetjeve të mësipërme tregojnë më së shumti se projekti ka një shans për t'u zbatuar me sukses në formulën PPP, duhet të kaloni në analizën sasiore.

11.3 Analiza sasiore e vlerës për para

Analiza sasiore e vlerës për para bazohet në një krahasim të flukseve financiare të sektorit publik në të dy skenarët.

Për këtë qëllim është e nevojshme të ndërtohet një model financiar për zbatimin e projektit në formulën tradicionale (metoda e skontuar e fluksit monetar), i ashtuquajtur i Krahasues i Sektorit Publik (PSC).



Vlera aktuale e flukseve financiare të sektorit publik krahasohet me vlerën aktuale të flukseve monetare të njësisë publike në modelin PPP gjatë së njëjtës periudhë analize, duke përdorur të njëjtën normë interesi¹⁵. Gjatë zhvillimit të modelit krahasues të sektorit publik, i cili paraqet projektimin e fluksit monetar për skenarin në të cilin autoritetet publike zbatojnë projektin, është e nevojshme të merren parasysh disa hapa të rëndësishëm për ta bërë atë të krahasueshëm me modelin PPP. Hapat paraqiten në tabelën e mëposhtme.

¹⁵ Supozimi kryesor është se parametrat e projektit të referencës janë të njëjtë për të dyja modelet e zbatimit të investimit, si për sa i përket objektit material dhe standardit të objektit dhe shërbimeve të ofruara. Nuk do të thotë të njëjtën nivel kostosh dhe/ose të ardhurash në të dy skenarët.



Tabela 2: Hapat në analizën sasiore e vlerës për para

Nr.	Hapi	Komenti
1	Të identifikohen kostot dhe të ardhurat dhe të parashikohen flukset monetare për zbatimin e projektit, duke përdorur metodën tradicionale	Projektimi do të përfshijë shpenzimet kapitale, kostot operative, kapitalin qarkullues, të ardhurat nga përdoruesit dhe palët e treta (nëse ka ndonjë), modelimin e flukseve tatimore etj. Gjithashtu, duhet të merret parasysh që subjekti publik mund ta zbatojë projektin në një datë të ndryshme se sa data në modelin PPP (planet e zbatimit mund të ndryshojnë midis skenarëve). Kostot e skontuara neto të zbatimit të projektit në PSC në këtë fazë quhen kosto bazë.
2	Të merret parasysh rreziku në PSC	Në secilin variant, përcaktimi sasior i rreziqeve që mund t'i transferohen partnerit privat kërkon identifikimin paraprak të rreziqeve dhe shpërndarjen e tyre ndërmjet subjektit publik dhe partnerit privat. Krahasuesi i sektorit publik duhet të marrë parasysh vlerën e rreziqeve që do t'i transferoheshin partnerit privat nëse projekti zbatohet në formulën PPP ¹⁶ . Nëse një risk specifik ndahet ndërmjet subjektit publik dhe partnerit privat, vetëm pjesa e riskut që do t'i transferohej partnerit privat sipas opsionit PPP duhet të përfshihet në PSC.
3	Të përfshihet ndryshimi në koston dhe përfitimin social-ekonomik në PSC	Megjithëse në të dy skenarët ne konsiderojmë një projekt të ngjashëm, metodologjia e llogaritjes së vlerës për para lejon marrjen parasysh të diferencave në orarin e zbatimit të një projekti të caktuar, të cilat mund të rezultojnë në disponueshmërinë e mëvonshme të aktivitetit ose një fillim të mëvonshëm të ofrimit të shërbimeve.
4	Të përfshihet neutraliteti fiskal	Është e rëndësishme të sigurohet që diferencat në flukset tatimore të mos ndikojnë në rezultatet e analizës dhe krahasueshmërinë e opsionit konvencional me opsionin PPP. Përfitimet e mundshme të një uljeje tatimore ose një takse të paguar më pak në PSC duhet të rregullohen.
5	Llogaritja e NPV-së për raportin PSC dhe VfM	Llogaritja e vlerës aktuale për flukset e përcaktuara nga krahasuesi i sektorit publik dhe krahasimi me vlerën aktuale për formulën PPP, duke përdorur të njëjtën normë skontimi është hapi i fundit.

Nëse, si rezultat i krahasimit të vlerave aktuale për të dy modelet e ofrimit, vlera aktuale që rezulton e flukseve të subjektit publik në modelin PPP është më e lartë se vlerat e vlerësuara PSC, kjo tregon një efikasitet më të lartë të modalitetit PPP.

Së fundi, vendimi për të zgjedhur metodën e zbatimit të projektit duhet të bazohet në analizën cilësore dhe sasiore, duke përfshirë testimin e tregut, i cili duhet të japë një përgjigje në çfarë niveli tregu mund të përfundojë projektin brenda parametrave të supozuar.

Në rast të përzgjedhjes së opsionit PPP si forma më e mirë e zbatimit të një projekti institucioni propozues duhet të paraqesë edhe vlerësimet mbi vlerën e parashikuar të kontratës, kohëzgjatjen e propozuar të kontratës, si edhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, kostot e mirëmbajtjes etj., në përputhje me legjislacionin për koncesionet dhe PPP.

12. Ndikimet mjedisore dhe sociale

12.1 Ndikimi në mjedis, duke marrë parasysh përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike

Përshkrimi i paraqitur në këtë pikë duhet t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Si kontribuon projekti në politikat kombëtare mjedisore?

- Cili është ndikimi i pritshëm i projektit në ndryshimin e klimës?¹⁷

- Si merren apo duhet të merren parasysh në kuadër të projektit zbutja e ndryshimeve klimatike dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike?¹⁸

- A është projekti elastik ndaj ndryshimeve klimatike sipas skenarëve të ndryshëm klimatikë?

- A kërkohet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) me ligj për projektin?

- Nëse kërkohet, cilat janë rezultatet e VNM-së paraprake?

- A është parashikuar ndonjë ndikim negativ mjedisor?

¹⁶ Rreziqet të cilat, pavarësisht nga skenari i miratuar i zbatimit të investimit, mbeten te sektori publik (të ashtuquajturat rreziqe të mbajtura) nuk janë të nevojshme të përfshihen në analizën sasiore të vlerës së parasë, sepse nuk i diferencojnë skenarët.

¹⁷ Nëse ka kosto ose përfitime të rëndësishme që lidhen me ndikimin e projektit në ndryshimet klimatike, ato duhet të monetizohen dhe të përfshihen në analizën ekonomike.

¹⁸ Për informacion se si të integrohen konsideratat klimatike në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, shihni: Udhëzuesin për Integrimin e Ndryshimeve Klimatike dhe Biodiversitetit në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Komisioni Evropian, 2013.



- Cilat janë masat zbutëse të propozuara dhe a janë të pranueshme ndikimet përfundimtare?

Është e zakonshme që projektet të kenë disa ndikime negative mjedisore, të cilat, kudo që është e mundur, duhet të shprehen në terma sasiorë (niveli i shqetësimit mjedisor dhe numri i njerëzve/familjeve të prekura). Prandaj është e rëndësishme që të merren parasysh masat zbutëse për t'i trajtuar ato. Ndikimet negative dhe mjetet e propozuara të zbutjes duhet të përmbledhen këtu dhe të përshihen në analizën ekonomike ku vlerësimi është i mundshëm¹⁹.

12.2 Ndikimi social

Duke qenë se përfitimet dhe kostot e projektit shpesh shpërndahen në mënyrë disproporcionale në grupe të ndryshme të shoqërisë, ndikimet sociale duhet të merren në konsideratë me kujdes. Qëllimi i këtij aktiviteti nuk është vlerësimi i pasojave sociale të projektit, pasi kjo duhet të jetë objekt i analizës ekonomike, por për të vlerësuar se deri në çfarë mase do të preken grupe të veçanta. Në disa raste, mund të ndodhë që një projekt me vlera relativisht të ulëta të treguesve ekonomikë të ketë ndikim shumë pozitiv në grupet e konsideruara si vulnerabël në zona të caktuara (p.sh. gratë ose banorët e rajoneve të privuara). Kjo duhet të merret në konsideratë nga vendimmarrësit. Një vlerësim i ndikimit social zakonisht do të marrë parasysh ndikimin e projektit në nivelet e të ardhurave, varfërinë, papunësinë, barazinë gjinore dhe minoritetet.

Mënyra më e mirë për të siguruar dëshmi se ndikimet sociale të projektit janë marrë në konsideratë, siç duhet është përfshirja e grupeve të prekura në konsultime kuptimplotë me palët e interesuara dhe prezantimi i gjetjeve dhe veprimeve të mëvonshme ose të planifikuara që rezultojnë prej tyre. Ky seksion duhet të paraqesë, gjithashtu, masat zbutëse për ata që janë të prekur negativisht, p.sh. banorët të prekur nga zhurma nga një rrugë e re.

Aty ku projektet pritet të kenë ndikime negative sociale mbi grupet e veçanta të interesit, atyre duhet t'u kushtohet një konsideratë e veçantë për të shmangur mosmarrëveshjet e mundshme dhe vonesat në zbatim. Duhet përcaktuar mënyra e monitorimit të ndikimeve sociale.

13. Zbatimi dhe qëndrueshmëria operacionale

13.1 Aftësitë e subjekteve zbatuese dhe operuese

Në këtë seksion të studimit të fizibilitetit duhet të përshkruhen aftësitë e subjekteve zbatuese dhe operuese në lidhje me:

- Kapacitetin teknik (të paktën jepni një pasqyrë të ekspertizës së nevojshme për zbatimin e projektit dhe tregoni numrin e stafit me ekspertizë të tillë të disponueshëm brenda organizatës dhe të alokuar për projektin).

- Kapacitetin ligjor (si informacion minimal, tregoni statusin ligjor të përfituesit që lejon zbatimin e projektit dhe kapacitetin e tij për të ndërmarrë veprime ligjore, nëse është e nevojshme).

- Kapacitetin financiar (një përmbledhje të shkurtër përshkruese të rezultateve të analizës së qëndrueshmërisë financiare); minimalisht konfirmoni gjendjen financiare të organit përgjegjës për zbatimin e projektit, për të treguar se mund të garantojë likuiditetin për financimin e duhur të projektit, për të siguruar zbatimin e suksesshëm dhe funksionimin e tij në të ardhmen, përveç aktiviteteve të tjera të organit).

- Kapacitetin administrativ (si informacion minimal, tregoni projektet e krahasueshme të realizuara në dhjetë vjetët e fundit dhe, në mungesë të shembujve të tillë, tregoni nëse janë marrë parasysh nevojat për asistencë teknike; referojuni përgatitjeve institucionale siç është ekzistenca e Njësisë për Zbatimin e Projekteve (NJZP), të aftë për të zbatuar dhe operuar projektin dhe, nëse është e mundur, të përfshihet skema organizative e propozuar për zbatimin dhe funksionimin e projektit).

Qëllimi i këtij seksioni është të tregohet se propozuesi i projektit ka kapacitetin për të zbatuar projektin me sukses. Vlerësimi duhet të marrë në konsideratë madhësinë dhe kompleksitetin e projektit kundrejt burimeve të disponueshme zbatuese (për sa i përket sasisë dhe cilësisë) të autoritetit propozues. Gjithashtu, duhet t'i përgjigjet pyetjes nëse propozuesi ka përvojë në projekte të ngjashme. Kjo pyetje është veçanërisht e rëndësishme në rastin e zbatimit të PPP-së. Në rastet kur është e qartë se burimet e brendshme janë të

¹⁹ Nëse vlerësimi i drejtpërdrejtë nuk është i realizueshëm, mund të përdoren metodat e transferimit të vlerës.



pamjaftueshme, duhet të sigurohen mjete realiste për të sjellë asistencë të jashtme.

13.2 Pasqyrë e përgjithshme e përgatitjeve të menaxhimit të projektit

Në këtë seksion duhet të paraqiten përgatitjet e menaxhimit të projektit. Këtu duhet të përshkruhen rolet dhe përgjegjësitë e subjekteve përkatëse. Ai duhet të tregojë se detyrat janë ndarë si duhet, duke marrë parasysh përvojën dhe burimet e subjekteve përgjegjëse. Marrëveshjet organizative duhet të paraqiten si për fazën e zbatimit, ashtu edhe për periudhën operative. Seksioni synon të sigurojë që rreziqet që lidhen me menaxhimin e projektit janë minimizuar.

14. Analiza e riskut dhe sensitivitetit

14.1 Burimet kryesore të riskut dhe ndikimet e tyre të mundshme, masat reduktuese

Një risk është një ngjarje ose gjendje e pasigurt që, nëse ndodh, ka një efekt pozitiv ose negativ në një projekt. Risqet ekzistojnë si pasojë e pasigurisë në lidhje me parametrat kryesorë të një projekti (p.sh. kostoja, koha e zbatimit, kërkesa për shërbime etj.). Në përgjithësi, pasiguria prodhon ekspozim ndaj riskut në dështimin për të:

- qenë në linjë me buxhetin e projektit;
- arrirë datën e kërkuar të përfundimit të projektit;
- përmbushur specifikimet e kërkuara të projektimit; dhe
- arrirë qëllimin e kërkuar të projektit.

Secili prej këtyre rezultateve do të kishte një ndikim negativ në vlerësimin e NPV-së dhe ENPV-së.

Analiza e riskut dhe menaxhimi i riskut përfaqësojnë një qasje të strukturuar për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që mund të shfaqen gjatë kohëzgjatjes së një projekti. Risqet mund të kategorizohen si më poshtë:

- Risku i ndërtimit: Aseti i papërfunduar në kohë, sipas buxhetit ose specifikimeve;
- Risku i kërkesës: Kërkesa për shërbime nuk i plotëson parashikimet;

- Risku i projektimit: Projektimi nuk mund të ofrojë shërbime sipas standardeve të kërkuara të performancës ose cilësisë;

- Risku ekonomik: kostot ose përfitimet e projektit të ndikuara nga ndikimet ekonomike, p.sh., inflacioni ose lëvizjet e kursit të këmbimit;

- Risku mjedisor: Ndikimet negative mjedisore shkaktojnë kundërshtime të mëdha nga publiku;

- Risku i financimit: Disponueshmëria e financimit vonon projektin ose ndryshon objektin;

- Risku legjislativ: Ndryshimet në legjislacion rrisin kostot, p.sh. shtrëngimi i standardeve mjedisore;

- Risku i operimit dhe mirëmbajtjes: Kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes së objektit të ri ndryshojnë nga buxheti i planifikuar;

- Risku i prokurimit: Mungesa e kapaciteteve të kontraktorëve ose mosmarrëveshjet kontraktuale;

- Risku teknologjik: Shërbimet e ofruara duke përdorur teknologji jo optimale për shkak të ndryshimeve të shpejta teknologjike;

- Risqet nga ndryshimet klimatike²⁰: a mundet që projekti të ndikohet nga ndonjë rrezik i shkaktuar nga ndryshimet klimatike gjatë zbatimit ose fazës operacionale;

- Risqet nga fatkeqësia: a mundet që projekti të ndikohet nga ndonjë rrezik natyror gjatë zbatimit ose performancës operacionale.

Analiza e riskut duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm:

- Identifikimin e risqeve (të përmendura më sipër) për zbatimin e suksesshëm të projektit;

- Probabilitetin e ndodhjes: Probabiliteti është numri ndërmjet 0 dhe 5, ku 0 nënkupton që një materializim është shumë i pamundur dhe 5 tregon se ndodhia është e sigurt.

- Vlerësimi i ndikimit të riskut: Ndikimi i riskut është një numër midis 0 dhe 5, ku 0 do të thotë se ndikimi në projekt do të jetë i parëndësishëm dhe 5 tregon një ndikim të madh në projekt.

- Renditja e kategorive – klasifikoni risqet në kategoritë që paraqesin se ato mund të ndodhin dhe ndikimin e tyre.

²⁰ Në kapitullin tjetër jepen udhëzime të detajuara.

**Tabela 3:** Shembull i matricës së riskut

		Impakti				
		Minimal	I vogël	I moderuar	Kritik	Katastrofik
Probabiliteti	Shumë e pamundur	I ulët	I ulët	I ulët	I ulët	Mesatar
	Nuk ka gjasa	I ulët	I ulët	Mesatar	Mesatar	I lartë
	Afërsisht aq e mundshme sa jo	I ulët	Mesatar	Mesatar	I lartë	I lartë
	Ka gjasa	I ulët	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë	Shumë i lartë
	Shumë të ngjarë	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë	Shumë i lartë	Shumë i lartë

Burimi: Udhëzues për analizën kosto-përfitim të projekteve investuese, Komisioni Evropian, 2014

- Zhvillimi dhe paraqitja e masave të zbatueshme për reduktimin dhe menaxhimin e riskut

14.2 Vlerësimi i riskut të ndryshimeve klimatike me masa reduktuese

Shqyrtimi i ndryshimeve klimatike në këtë fazë tregon se projekti ka një nivel risku nga ndryshimet klimatike. Objektivi i vlerësimit të riskut mbetet identifikimi i rreziqeve të rëndësishme klimatike, si bazë për identifikimin, vlerësimin dhe zbatimin e masave të synuara për reduktimin e riskut. Në këtë fazë, Propozuesi i Projektit do të ketë nivel bazë të njohurive në lidhje me cenueshmërinë e projektit ndaj ndryshimeve klimatike. Rreziqet e identifikuara të lidhura me ndryshimet klimatike duhet të konsiderohen si kërcënime për zbatimin dhe funksionimin e suksesshëm të projektit, megjithëse nëse mbeten paqartësi, duhet të kërkohen të dhëna të detajuara për të konfirmuar ose zgjeruar vlerësimin fillestar të cenueshmërisë. Pasi të konfirmohet cenueshmëria, vlerësimi i riskut mund të shprehet në formën e një matrice standarde të riskut.

Vlerësimi i detajuar i riskut do të kërkojë shqyrtim të veçantë të çdo risku të identifikuar të lidhur me ndryshimet klimatike në lidhje me projektin. Ai duhet të bazohet në vlerësimin e mundësisë së ndodhisë së një rreziku të caktuar (probabiliteti) dhe madhësisë së ndikimit (ndikimit) të tij në projekt. Niveli i riskut është një kombinim i dy faktorëve: probabilitetit dhe fuqisë së ndikimit. Sa më i lartë të jetë niveli i riskut, aq më intensive janë veprimet korrigjuese të nevojshme për të luftuar rrezikun. Aty ku rreziku është shumë i lartë dhe përshtatja është shumë e shtrenjtë, braktisja e projektit është veprimi përfundimtar, por ka më shumë gjasa që do të duhet të hartohen masa përshtatëse me kosto efektive. Sa më lokale dhe specifike të jenë të dhënat, aq më i saktë dhe më përkatës do të jetë vlerësimi. Në tabelën 2 përcaktohet niveli i riskut në varësi të nivelit të probabilitetit dhe fuqisë së ndikimit.

Tabela 4: Matrica e riskut

		Impakti				
		Minimal	I vogël	I moderuar	Kritik	Katastrofik
Probabiliteti	Shumë e pamundur	I ulët	I ulët	I ulët	I ulët	Mesatar
	Nuk ka gjasa	I ulët	I ulët	Mesatar	Mesatar	I lartë
	Afërsisht aq e mundshme sa jo	I ulët	Mesatar	Mesatar	I lartë	I lartë
	Ka gjasa	I ulët	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë	Shumë i lartë
	Shumë të ngjarë	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë	Shumë i lartë	Shumë i lartë

Burimi: Udhëzues për analizën kosto-përfitim të projekteve investuese, Komisioni Evropian, 2014

Një probabilitet ose mundësi e ndodhisë duhet t'i atribuohet çdo rreziku të identifikuar. Probabiliteti i shfaqjes së një rreziku klimatik është i vështirë për t'u vlerësuar, sepse ka shumë pasiguri në lidhje me rrugën e ardhshme të ndryshimit klimatik dhe efektet e tij të lokalizuara. Për qëllime të vlerësimit të detajuar të riskut në Shqipëri, sugjerohet që, sipas udhëzimeve të BE-së, të përdoret një skenar që përfshin një rritje prej 2°C të temperaturave mesatare globale deri në vitin 2050, duke mbetur e qëndrueshme më



pas²¹. Për projekte të mëdha dhe komplekse duhet të merren parasysh edhe skenarë të tjerë, më ekstremë, gjatë kryerjes së analizave të sensitivitetit. Klasifikimi i rekomanduar i probabiliteteve është si më poshtë²²:

- shumë e pamundur - 0–10% probabilitet;
- e pamundur - 10–33% probabilitet;
- pothuajse po aq e mundshme sa edhe jo - 33–66% probabilitet;
- gjasa - 66–90 % probabilitet;
- shumë e mundshme - 90–100% probabilitet.

Madhësia e ndikimit të rrezikut në projekt dhe performanca e tij operationale duhet të klasifikohet sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- minimale – pa efekt;
- i vogël – efekt i vogël në objektivat dhe përfitimet e pritshme të projektit, të cilat mund të minimizohen më tej duke ndërmarrë veprime të vogla korrigjuese;
- i moderuar- efekt i moderuar në objektivat dhe përfitimet e pritshme të projektit, të cilat mund të minimizohen, gjithashtu, duke ndërmarrë veprime korrigjuese;
- kritik – ndikim i fortë negativ në objektivat dhe përfitimet e pritshme të projektit, i cili është jashtëzakonisht i vështirë për t'u kundërshtuar duke ndërmarrë veprime korrigjuese;
- katastrofike – ndikim shumë serioz, negativ në objektivat dhe përfitimet e pritshme të projektit, që mund të rezultojë në një humbje serioze apo edhe totale të efekteve të supozuara fillimisht.
- Matrica e riskut lejon planifikimin fillestar të përgjigjeve ndaj riskut. Në varësi të nivelit të riskut, duhet të zbatohen masa të ndryshme reduktimi në projekt. “Intensiteti” i masës duhet të jetë në përpjesëtim me nivelin e riskut. Për rreziqet me një nivel të lartë ndikimi dhe probabiliteti, duhet të ndiqet një përgjigje më e fortë dhe një nivel më i lartë i përkushtimit për menaxhimin e tyre. Nga ana tjetër, për risqet e nivelit të ulët, monitorimi i afërt ose masat e vogla reduktuese mund të jenë të mjaftueshme. Mbajtja e opsionit në hartimin e projektit për përshtatjen e ardhshme është, gjithashtu, një përgjigje, ku pasiguria mbi efektet e lokalizuara të ndryshimeve klimatike është e lartë²³.

Masat e identifikuar për reduktimin e riskut do të paraqiten së bashku me identifikimin nga ana e menaxherit përkatës të riskut në nivel projektit, si dhe fazën e kohëzgjatjes së projektit kur risku mund të materializohet (planifikimi, zbatimi, funksionimi). Së fundi, në elasticitetin e projektit dhe ekspozimin e mbetur ndaj riskut duhet të vlerësohen ndikimet e masave të preferuara për reduktimin e riskut. Për çdo ngjarje negative, është e nevojshme të vlerësohet risku i mbetur pas zbatimit të masave të identifikuar. Karakteristikat e secilit risk të identifikuar të lidhur me klimën mund të paraqiten në një formë siç tregohet në tabelën 5.

Tabela 5: Forma karakteristike e riskut

Specifikimi	Përshkrimi
Risku i identifikuar (rreziku i mundshëm klimatik)	Thatësira, përmytja etj....
Faza e projektit që është në rrezik	Planifikimi, zbatimi, funksionimi
Probabiliteti i ndodhësë	Shumë e pamundur/e pamundur/pothuajse aq e mundshme sa jo/e mundshme/shumë e mundshme
Ndikimi	Minimal/i vogël/i moderuar/kritik/katastrofik
Niveli i riskut	Sipas matricës së riskut bazuar në probabilitetin dhe ndikimin (e ulët/e mesme/e lartë/shumë e lartë)
Masat e mundshme të identifikuar për reduktimin e riskut (opsionet e përshtatjes së projektit)	Të identifikohen masat që do të kufizojnë ndikimin e riskut në projektin tuaj. Vlerësimi i opsioneve të ndryshme do të jetë subjekt i analizës me shumë kritere ose analizës së përfitimit të kostos, aty

²¹ Është në përputhje me objektivin e vendosur në Marrëveshjen e Parisit për mbajtjen e rritjes së temperaturës mesatare globale nën 2°C mbi nivelet paraprake industriale.

²² IPCC, 2012: Menaxhimi i risqeve të ngjarjeve ekstreme dhe fatkeqësive për përshtatjen e avancuar ndaj ndryshimeve klimatike.

²³ Mbajtja e opsionit për përshtatjen në të ardhmen mund të kërkojë opsionin të “projektohet” dhe mund të kërkojë disa shpenzime fillestare.



	ku është e aplikueshme.
Masat e zgjedhura për parandalimin e riskut	Të paraqiten masat e zgjedhura të parandalimit të riskut të zbatueshme për projektin.
Kush do të jetë përgjegjës për menaxhimin e riskut të identifikuar të ndryshimeve klimatike?	P.sh., departamenti i dedikuar në ministri ose në bashki.
Niveli i vlerësuar i riskut të mbetur (pas zbatimit të masave të identifikuara dhe të zgjedhura të parandalimit të riskut)	Ju lutemi vlerësoni nivelin e riskut të mbetur dhe shpjegoni se si masat e parashikuara zbutëse trajtojnë dhe ulin rrezikun.

Vlerësimi i riskut të klimës në përgjithësi përcakton rreziqet e mundshme për sa i përket riskut, dhe për këtë arsye jep një bazë solide për vlerësimin e urgjencës së veprimeve të përshtatjes. Krijimi i një grupi opsionesh përshtatjeje, nga këndvështrimi i një projekti të caktuar investimi publik, kërkon një qasje praktike. Një qasje e tillë duhet të përfshijë, mbi të gjitha, dallimin e disa opsioneve të adaptimit potencialisht ekonomikisht efektive dhe më pas vlerësimin e këtyre opsioneve për të zgjedhur qasjen optimale.²⁴

14.3 Plani i menaxhimit të riskut

Plani i menaxhimit të riskut (i shprehur përmes një “regjistri të riskut”) duhet të tregojë se kush do të jetë përgjegjës për menaxhimin e çdo risku individual dhe si t’i përgjigjet riskut nëse ai duhet të materializohet. Risqet menaxhohen më mirë kur anëtarët individualë të ekipit të projektit (më tepër sipas titullit se emri) janë përgjegjës për monitorimin dhe menaxhimin e çdo risku, prandaj një pozicion i tillë duhet të tregohet për çdo risk të identifikuar. Regjistri i riskut kërkohet veçanërisht për fazën e studimit të fizibilitetit dhe mund të ketë një formë më pak të detajuar për fazën e studimit paraprak të fizibilitetit. Në përgjithësi, kjo e bën shumë më të lehtë detyrën e monitorimit të risqeve gjatë fazave të zbatimit dhe faqes operacionale.

14.4 Analiza e sensitivitetit

Analiza e sensitivitetit përfshin përcaktimin e masës në të cilën rezultatet e analizës ekonomike të kuantifikuara janë sensitive ndaj ndryshimeve në vlerat e parametrave kryesorë të inputit si kostot e kapitalit, kërkesa e ardhshme ose vlera e përfitimeve. Kryerja e analizës së sensitivitetit mundëson rillogaritjen e treguesve ekonomikë të projektit mbi bazën e vlerave më pak optimiste për variabla të rëndësishme, ose duke përdorur supozime më pak të favorshme. Në përgjithësi, ai përfshin ngritjen e elementeve të rëndësishme të kostove ose

reduktimin e përfitimeve të rëndësishme me përqindje të dhëna dhe vëzhgimin e ndikimit në ENPV. Përveç testimit të qëndrueshmërisë së vlerësimit të ENPV-së, analiza e sensitivitetit më të dobishëm ndihmon në identifikimin e atyre variabla që janë më kritikët për suksesin e projektit dhe që mund të kenë nevojë për menaxhim më të kujdesshëm (shihni planifikimin e menaxhimit të riskut më poshtë) ose analiza më të thella.

Në praktikë, vlerat për parametrat e dhënë për analizën ekonomike mund të jenë të ndërvarura ose t’u nënshtrohen paragjykitimeve sistematike të vlerësimit (shihni, për shembull, diskutimin e paragjykitimit të optimizimit më poshtë). Për këtë arsye, është e arsyeshme që të kryhen analiza të skenarëve ku analiza ekonomike e kuantifikuar u nënshtrohet ndryshimeve të njëkohshme në parametrat kryesorë të hyrjes për të testuar sensitivitetin e rezultateve. Mund të formulohen një numër skenarësh të ndryshëm “çfarë-nëse”, secili me kombinime të ndryshme të vlerave hyrëse për variablat dhe/ose supozimet kryesore. Dy skenarët që duhen marrë parasysh gjithmonë janë skenari i “rastit më të keq” dhe skenari i “rastit më të mirë”. Në këta dy skenarë, testohet sensitiviteti i qëndrueshmërisë ekonomike të projektit ndaj kombinimeve më pesimiste dhe optimiste të parametrave kyç të hyrjes.

Minimalisht duhet që të kryhen testet e mëposhtme, që përfaqësojnë rezultate më pak optimiste për kostot dhe përfitimet, dhe rezultatet e detajuara me përfundime të paraqitura në këtë kapitull:

- Të rillogaritet ENPV-ja duke supozuar një rritje prej 10% në kostot kapitale totale;
- Të rillogaritet ENPV-ja duke supozuar një rritje prej 25% në kostot kapitale totale;
- Të rillogaritet ENPV-ja duke supozuar një ulje prej 10% në përfitimet totale;

²⁴ Për udhëzime të mëtejshme mbi analizimin e opsioneve të përshtatjes shihni: “Udhëzuesi teknik për rezistencën nga klimës së infrastrukturës në periudhën 2021–2027”. Njoftimi i Komisionit Evropian, 2021/C 373/01.



- Të rillogaritet ENPV-ja duke supozuar një ulje prej 25% në përfitimet totale;

- Të rillogaritet ENPV-ja duke supozuar një rritje të njëkohshme të kostove kapitale prej 10% dhe ulje të përfitimeve prej 10% - skenari bazë pesimist.

- Të rillogaritet ENPV-ja, duke supozuar një rritje të njëkohshme të kostove kapitale prej 25% dhe ulje të përfitimeve prej 25% - skenari bazë i rastit më të keq.

15. Konkluzione mbi Fizibilitetin e Projektit

Në këtë kapitull duhet të paraqiten përfundimet që rezultojnë nga kapitujt e mëparshëm të studimit paraprak të fizibilitetit, me një tregues të qartë të fizibilitetit të projektit dhe një rekomandim për vendimin e vlerësimit.

Në parim, që një projekt të konsiderohet i zbatueshëm, ai duhet të plotësojë disa kriterë të ndryshme, për sa u përket aspekteve ligjore, teknike, financiare, mjedisore, sociale dhe ekonomike të analizuara gjerësisht në kapitujt e mëparshëm të dokumentit. Një ENPV pozitive (e rregulluar me rrezikun) përgjithësisht konsiderohet si një kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm për një vendim vlerësimi pozitiv, por përjashtimet janë të mundshme nëse ato justifikohen me kujdes. Prandaj, mund të ndodhë që një projekt, pavarësisht se ka një ENPV paksa negative, mund të rekomandohet për një vendim të vlerësimit pozitiv, sepse përfitimet u shtohen kryesisht anëtarëve të cënueshëm të shoqërisë ose sepse ka disa përfitime të rëndësishme mjedisore (ose përfitime të tjera) që nuk mund të vlerësohen lehtësisht. Nga ana tjetër, një projekt me një ENPV paksa pozitive mund të rekomandohet për një vendim vlerësimi negativ, sepse ka disa efekte të rëndësishme negative mjedisore që nuk janë vlerësuar ose sepse është shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimeve në kostot dhe përfitimet e vlerësuara (siç tregohet përmes analizës së sensitivitetit).

Fjalori

Aset – një burim me një vlerë ekonomike, në pronësi ose e kontrolluar, me qëllim të prodhimit të përfitimeve financiare dhe/ose ekonomike.

Përfituesi – një individ, grup ose subjekt që përfiton si rezultat i zbatimit të një projekti.

Raporti i kostos së përfitimit (BCR) – një rezultat krahasues nga një analizë e përfitimit të kostos. Një BCR mbi 1.0 është një rezultat pozitiv.

Projekti kapital – projekt që kërkon shpenzime kapitale për ta realizuar atë.

Shpenzimet kapitale – janë shpenzime të bëra me qëllim të blerjes ose përmirësimit të aseteve të tilla si prona, impiantet, ndërtesat, teknologjia (përfshirë sistemet e informacionit – si harduer, ashtu edhe softuer) ose pajisje.

Analiza e përfitimit të kostos (CBA) – një mjet për të analizuar projektet, duke krahasuar përfitimet e mundshme me kostot e vlerësuara të zbatimit të tij.

Analiza e efektivitetit të kostos (CEA) – një mjet për të vlerësuar projektet, për të analizuar mënyrën më ekonomike për të arritur objektivin e një projekti.

Modeli financiar diferencial – modeli financiar i përgatitur për një projekt, që krahason flukset monetare për njësinë ekonomike në skenarin “me projekt” dhe njësinë ekonomike në skenarin “pa projekt” dhe i krahason ato për të përcaktuar flukset diferenciale që përdoren për të përcaktuar treguesit e performancës financiare të projektit. Ky model vlerëson flukset e ardhshme monetare në dy skenarë – investimi dhe joinvestimi. Analiza financiare duhet të paraqesë kostot dhe të ardhurat që rezultojnë nga skenari i parë, minus kostot dhe të ardhurat që rezultojnë nga skenari i dytë.

Analiza ekonomike duke përdorur metodën e analizës kosto-përfitim (CBA) është një proces i krahasimit të kostove dhe përfitimeve të vlerësuara të një projekti, duke i llogaritur ato në terma monetarë, edhe kur çmimet e tregut nuk ekzistojnë, duke parashikuar rrjedhat vjetore gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe duke përdorur metodën e fluksit monetar të zbritur, për të marrë një vlerë aktuale neto të këtyre flukseve vjetore neto. Kjo metodë është një mjet që vlerëson nëse një sipërmarrje e caktuar ia vlen të zbatohet apo jo.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) – një studim i ndikimeve të pritshme (pozitive ose negative) të një projekti të propozuar në mjedis, me rekomandimet se si të zbuten ndikimet negative.

Studimi i fizibilitetit (FS) – një studim i plotë i realizueshmërisë së përgjithshme të një projekti të propozuar; duhet të mbulojë si aspektet teknike, ashtu edhe ato ekonomike të projektit dhe të mbështetet nga dokumentacioni teknik paraprak. Përgatitja e një studimi fizibiliteti shpesh kërkon mbledhjen e të dhënave parësore.



Analiza financiare – analizë që synon përcaktimin e vlerës së treguesve të performancës financiare të projektit dhe verifikimin e qëndrueshmërisë financiare të projektit. Zakonisht bëhet nga këndvështrimi i pronarit të infrastrukturës. Në rast se ka disa subjekte në projekt (p.sh. pronari i infrastrukturës dhe operatori i saj), duhet të kryhet një analizë e konsoliduar që tregon projektin në tërësi (analizë e konsoliduar). Në analizën financiare, metoda e fluksit monetar të zbritur (DCF) përdoret për të përcaktuar raportet e efikasitetit financiar.

Qëndrueshmëria financiare – projekti konsiderohet financiarisht i qëndrueshëm kur burimet e disponueshme të financimit mund të përputhen me vlerën e disbursimeve në një mënyrë që të ketë një bilanc pozitiv të parasë (flukse kumulative parash) në çdo fund viti, në horizontin kohor të projektit (si gjatë zbatimit dhe fazave operative).

Asetet fikse – asetet që përdoren në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme në proceset e prodhimit për më shumë se një vit.

Inputet – përbërësit e kërkuar të nevojshëm për të zbatuar një projekt.

Norma e Brendshme e Kthimit (IRR) – norma e skontimit që prodhon një NPV zero.

Investimi – blerja e një aktivi me pritshmërinë e gjenerimit të një rrjedhe përfitimesh të ardhshme.

Rruga Logjike – një numër hapash që synojnë të shndërrojnë një nevojë në rezultate dhe ndikime pozitive.

Analiza me shumë kriterë (MCA) – një mjet për të analizuar dhe krahasuar opsione të ndryshme kundrejt një numër kriteresh të rëna dakord paraprakisht.

Vlera aktuale neto (NPV) – shuma e flukseve monetare të skontuara neto të një projekti.

Objekti – arritja e kërkuar për projektin; duhet të adresojë problemin ose nevojën e identifikuar.

Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes – kostot totale vjetore të funksionimit të një projekti operacional, duke përfshirë kostot e personelit, kostot e mirëmbajtjes së vazhdueshme, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të prokurohen për funksionimin efikas të një objekti.

Rezultati – përfitimet e drejtpërdrejta të projektit, të nevojshme për të adresuar problemin ose nevojën e identifikuar.

Output – produktet përfundimtare të inputeve dhe aktiviteteve në një projekt.

Studimi paraprak i fizibilitetit (PFS) – një studim që zakonisht ndërmerret për projekte të mëdha ose komplekse për të hetuar nëse përgatitja e një studimi fizibiliteti më të detajuar (dhe të shtrenjtë) është i justifikuar. Metodologjikisht është njësoj si një studim fizibiliteti, por zakonisht bazohet në analizën e të dhënave ekzistuese (ose mbledhja e të dhënave parësore kryhet në një shkallë shumë të kufizuar).

Risqet e projektit – ngjarje që mund të shkaktojë një devijim nga rezultatet ose kostot e dëshiruara të një projekti.

Vlera e mbetur – potenciali financiar ose ekonomik i projektit në vitet e mbetura të kohëzgjatjes së tij (kohëzgjatja ekonomike), e llogaritur në vitin e fundit të periudhës referuese të përdorur për analizën. Kjo vlerë do të jetë zero ose afër zeros nëse periudha e referencës është afër kohëzgjatjes ekonomike të aktiveve fikse. Rekomandohet të matet vlera e mbetur si vlera e aktiveve fikse neto, e përcaktuar, duke përdorur metodën e amortizimit dhe periudhën në përputhje me politikën kontabël të operatorit.

Çmimi në hije – fitimi i përfitimeve dhe kostove në mungesë të çmimeve të tregut.

Norma e skontimit social – norma e skontimit e përdorur në analizën ekonomike; ajo pasqyron këndvështrimin social mbi mënyrën sesi përfitimet dhe kostot e ardhshme duhet të vlerësohen kundrejt atyre të tanishme.

Vlerësimi i Ndikimit Social – vlerësimi i pasojave sociale të projektit. Ai fokusohet në shpërndarjen e përfitimeve dhe kostove për grupe të ndryshme në shoqëri dhe kërkohen rekomandime mbi zbutjen e ndikimeve negative.

Pala e interesuar – një individ, grup ose subjekt me interes në një projekt.

Metodat e transferimit të vlerës – përdoren për të vlerësuar përfitimet dhe kostot jotregtare të projektit duke transferuar (dhe përshtatur) informacionin nga studimet e përfunduara në vende ose kontekste të tjera.

Gatishmëria për të paguar – mat shumën maksimale të parave që konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë për një njësi të një malli të caktuar. Kjo metodë përdoret për të vlerësuar përfitimin/et e drejtpërdrejtë, në lidhje me përdorimin e mallrave ose shërbimeve të ofruara nga

projekti. Metoda ËTP bën një vlerësim të vlerës së parase përmes preferencave të zbuluara nga përdoruesit ose preferencave të deklaruara.

Gatishmëria për të pranuar – mat sasinë minimale të parave që konsumatorët janë të gatshëm të pranojnë për të përballuar një eksternalitet negativ.

SHTOJCA 2 STUDIMI I THJESHTUAR I FIZIBILITETIT

TABELA E PËRMBAJTJES E STUDIMIT TË THJESHTUAR TË FIZIBILITETIT

1. Përmbledhje ekzekutive

- 1.1 Informacion i përgjithshëm mbi projektin
- 1.2 Problematikat e identifikuara
- 1.3 Rëndësia e projektit
- 1.4 Objektivat kryesorë
- 1.5 Përfundimet kryesore

2. Analiza e nevojës dhe e problemit

- 2.1 Arsytimi i ndërhyrjes
- 2.2 Përshkrimi i problemit
- 2.3 Ndikimet aktuale

3. Objektivat e Projektit

- 3.1 Objektivi i përgjithshëm
- 3.2 Objektivat specifikë
- 3.3 Treguesit kryesorë

4. Përputhshmëria me politikat dhe strategjitë kombëtare/vendore

- 4.1 Strategjitë me të cilat është në përputhje projekti
- 4.2 Integrimi në planet zhvillimore sektoriale apo vendore

5. Analiza e alternativave

- 5.1 Përshkrimi i opsioneve të mundshme (përfshirë “pa projekt”)
- 5.2 Alternativa e përzgjedhur

6. Përshkrimi teknik i Projektit të zgjedhur

- 6.1 Komponentët kryesorë teknikë, teknologjia, afatet, përmasat, infrastruktura

7. Analiza ekonomike dhe sociale (kosto-përfitim)

- 7.1 Kostot kryesore
- 7.2 Përfitimet për komunitetin
- 7.3 Ndikimi social

8. Vlerësimi financiar dhe burimet e financimit

- 8.1 Kosto investimi
- 8.2 Burimet e financimit

8.3 Analizë mbi përballueshmërinë

9. Vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe klimë

9.1 Rreziqet mjedisore, ndikimi klimatik

9.2 Kërkesat ligjore për ndikimet në mjedis dhe klimë

10. Rreziqet kryesore dhe masat për zbutjen e rreziqeve

10.1 Rreziqet kryesore

10.2 Menaxhimi i rreziqeve

11. Plani i zbatimit dhe menaxhimi i projektit

11.1 Hapat kryesorë të implementimit

11.2 Aktorët përgjegjës

11.3 Koordinimi ndër-institucional

12. Konkluzione mbi fizibilitetin e Projektit

Hyrje

Ky udhëzim ka për qëllim të ofrojë një metodologji për përgatitjen e studimeve të thjeshtuara të fizibilitetit, të destinuara për njësitë e qeverisjes qendrore në Republikën e Shqipërisë. Ky udhëzim synon të orientojnë në mënyrë të qartë dhe të strukturuar procesin e përgatitjes dhe përmbajtjes së studimeve të thjeshtuara të fizibilitetit, të cilat përdoren si mjet bazë për vlerësimin e projekteve publike brenda kornizës së Menaxhimit të Investimeve Publike. Njësitë e qeverisjes qendrore, të cilat janë përgjegjëse për propozimin dhe menaxhimin e projekteve në nivel qendror, mbajnë përgjegjësinë kryesore për realizimin e vlerësimeve të plota dhe të saktë të projekteve. Ky udhëzim përcakton përmbajtjen minimale të nevojshme që duhet të përmbajnë studimet e thjeshtuara të fizibilitetit, në mënyrë që të sigurohet një bazë e besueshme dhe e standardizuar për marrjen e vendimeve mbi investimet publike.

Struktura e studimit të thjeshtuar të fizibilitetit, siç paraqitet në këtë udhëzim, nuk kërkon domosdoshmërisht përfshirjen e të gjitha elementeve të përshkruar më poshtë në çdo rast. Në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të projektit, si dhe nevojave specifike të institucioneve përgjegjëse, mund të përfshihen edhe elemente shtesë, të cilat do të adresojnë më mirë veçantitë e projektit në fjalë.

Në këtë mënyrë, udhëzimi siguron një kornizë fleksibile, por të qartë, për përgatitjen e studimeve të thjeshtuara të fizibilitetit, duke promovuar një proces efikas dhe transparent të vlerësimit të projekteve publike në Shqipëri.

Për informacione më të detajuara në përgatitjen e studimeve të thjeshtuara të fizibilitetit, referojuni

metodologjisë mbi përgatitjen e studimeve të plota të fizibilitetit.

1. Përmbledhje ekzekutive

1.1 Informacion i përgjithshëm mbi projektin

Në këtë seksion përshkruhet në mënyrë të shkurtër dhe të qartë projekti, duke përfshirë titullin, sektorin, vendndodhjen, kohëzgjatjen e tij etj. Jepet një pasqyrë e përgjithshme e natyrës së projektit dhe qëllimit kryesor që synohet. Përmenden aktorët kryesorë të përfshirë dhe konteksti i zhvillimit të projektit në kuadër të zonës apo sektorit përkatës.

1.2 Problematikat e identifikuar

Përfshihet një përshkrim i situatës aktuale, duke identifikuar boshllëqet dhe pengesat që ekzistojnë pa realizimin e projektit. Theksohet impakti negativ i këtyre problematikave në komunitet, sektor ose ekonomi. Këtu shpjegohen problemet, nevojat ose sfidat kryesore që projekti synon të adresojë.

1.3 Rëndësia e projektit

Në këtë pjesë sqarohet pse projekti është i rëndësishëm dhe çfarë përfitimesh do të sjellë në aspektin ekonomik, social, apo mjedisor. Përshkruhet ndikimi pozitiv që do të ketë realizimi i projektit në përmirësimin e kushteve ekzistuese dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës apo sektorit.

1.4 Objektivat kryesorë

Këtu prezantohen qëllimet kryesore që projekti synon të arrijë. Objektivat duhet të jenë të qartë, të matshëm dhe të lidhura drejtpërdrejt me zgjidhjen e problematikave të identifikuar. Përmenden rezultatet që pritet të arrihen gjatë dhe pas zbatimit të projektit.

1.5 Përfundimet kryesore

Në këtë seksion përmbledhen rezultatet kryesore dhe vlerësimet e përgjithshme nga analiza e studimit të fizibilitetit. Jepet një konkluzion mbi realizueshmërinë e projektit dhe përfitimet që sjell, duke sugjeruar edhe hapat e mëtejshëm për zbatimin e tij.

2. Analiza e nevojës dhe e problemit

2.1 Arsyetimi i ndërhyrjes

Ky seksion shpjegon arsyet dhe motivet që kërkojnë ndërhyrje përmes projektit. Ai paraqet një analizë të nevojës së menjëhershme për zgjidhjen e problemeve ekzistuese dhe tregon pse ndërhyrja është e domosdoshme në këtë moment, duke konsideruar ndikimin që do të ketë në përmirësimin e kushteve për komunitetin, sektorin apo mjedisin ku projekti do të zbatohet.

2.2 Përshkrimi i problemit

Në këtë pjesë përshkruhet në detaje problemi kryesor që projekti synon të trajtojë. Identifikohen faktorët që kontribuojnë në ekzistencën e këtij problemi, përfshirë faktorët socialë, ekonomikë dhe teknikë. Përshkrimi i qartë ndihmon në kuptimin e sfidave të projektit dhe thekson domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve të përshtatshme.

2.3 Ndikimet aktuale

Këtu shpjegohen efektet dhe pasojat që problemi ka aktualisht mbi komunitetin, ekonominë, mjedisin apo infrastrukturën ekzistuese. Përcaktohen dëmet ose pengesat që kanë shkaktuar këto ndikime, duke theksuar rëndësinë e ndërhyrjes së menjëhershme për të parandaluar përkeqësime të mëtejshme dhe për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme.

3. Objektivat e Projektit

3.1 Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm përmbledh qëllimin kryesor të projektit, që është arsyeja madhore për realizimin e tij. Ai shpreh ndryshimin ose përmirësimin që projekti synon të arrijë në mënyrë të përgjithshme, duke reflektuar ndikimin pozitiv që do të ketë në komunitet, sektor apo mjedis gjatë dhe pas zbatimit të tij.

3.2 Objektivat specifikë

Këto janë qëllime të detajuara dhe të matshme që projekti synon të arrijë në mënyrë konkrete gjatë periudhës së implementimit. Objektivat specifikë ndihmojnë në ndarjen e objektivit të përgjithshëm në hapa të qartë dhe të realizueshëm, që mund të monitorohen dhe vlerësohen nëpërmjet treguesve të përcaktuar.

3.3 Treguesit kryesorë

Në këtë seksion përshkruhen indikatorët ose treguesit që do të përdoren për të matur suksesin e projektit në arritjen e objektivave të tij. Këta tregues janë të lidhur direkt me rezultatet e pritura dhe mund të jenë sasiorë ose cilësorë, duke siguruar një bazë të qartë për monitorimin dhe raportimin e progresit të projektit.

4. Përputhshmëria me politikat dhe strategjitë kombëtare/lokale

4.1 Strategjitë me të cilat është në përputhje projekti

Kjo pikë identifikon politikat, strategjitë kombëtare apo ndërkombe të cilat projekti është në linjë. Përshkruhet sesi qëllimet dhe ndërhyrjet e projektit kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuar në dokumente



strategjike të qeverisë, si strategjitë sektoriale, strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian apo dokumente të BE-së.

4.2 Integrimi në planet zhvillimore sektoriale apo vendore

Ky seksion analizon pozicionimin e projektit, në kuadër të planeve konkrete zhvillimore të sektorëve përkatës (si arsimi, shëndetësia, infrastruktura etj.), apo planeve të zhvillimit vendor. Përshkruhet nëse projekti është pjesë e prioritetëve të autoriteteve lokale dhe në çfarë mënyre ai mbështet objektivat zhvillimore të zonës ku do të zbatohet.

5. Analiza e alternativave

5.1 Përshkrimi i opsioneve të mundshme (përfshirë “pa projekt”)

Në këtë pjesë përshkruhen të gjitha opsionet e mundshme për zgjidhjen e problemit apo nevojës së identifikuar, përfshirë edhe skenarin “pa projekt” (*status quo*). Secili opsion duhet të analizohet në aspektin teknik, financiar, mjedisor dhe social, duke treguar avantazhet dhe kufizimet përkatëse. Qëllimi është të vlerësohen alternativat që mund të arrijnë objektivat e projektit në mënyrën më efikase dhe të qëndrueshme.

5.2 Alternativa e përzgjedhur

Ky seksion paraqet alternativën që është zgjedhur për zbatim, duke ofruar një argumentim të qartë se përse është më e përshtatshme se opsionet e tjera. Përzgjedhja duhet të bazohet në analiza krahasuese të kostove, përfitimeve, ndikimeve dhe rreziqeve. Gjithashtu, duhet të theksohet se si kjo alternativë maksimizon përfitimet ekonomike e sociale, minimizon ndikimet negative dhe është në përputhje me qëllimet strategjike të projektit.

6. Përshkrimi teknik i projektit të zgjedhur

6.1 Komponentët kryesorë teknikë, teknologjia, afatet, përmasat, infrastruktura

Ky seksion përshkruan në mënyrë të përmbledhur elementet teknike dhe infrastrukturore të projektit të përzgjedhur. Ai përfshin informacion mbi komponentët fizikë (si ndërtesa, rrjete, pajisje etj.), teknologjinë që do të përdoret, si dhe afatet kohore për zbatimin e secilës fazë të projektit. Gjithashtu, përshkruhen përmasat e përgjithshme të ndërhyrjes, kapaciteti i saj funksional dhe vendndodhja gjeografike. Ky përshkrim duhet të jetë i mjaftueshëm për të ofruar një kuptim të qartë mbi strukturën dhe qëllimin teknik të projektit, duke

mbështetur më pas analizat financiare dhe ato të ndikimit.

7. Analiza ekonomike dhe sociale (kosto-përfitim)

7.1 Kostot kryesore

Në këtë seksion identifikohen dhe përshkruhen kostot kryesore që lidhen me realizimin e projektit. Këto përfshijnë shpenzimet për investimet, kostot operacionale dhe mirëmbajtjen, si dhe shpenzimet indirekte që mund të lidhen me zbatimin e projektit. Përfshirja e detajeve mbi kostot ndihmon në vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe në krahasimin me përfitimet e pritshme.

7.2 Përfitimet për komunitetin

Ky seksion përqendrohet te përfitimet konkrete që komuniteti lokal ose grupet e synuara do të marrin nga projekti. Përfitimet mund të jenë në formën e përmirësimit të infrastrukturës, krijimit të vendeve të punës, rritjes së aksesit në shërbime, përmirësimit të cilësisë së jetës apo rritjes së mundësive ekonomike. Përshkrimi i qartë i këtyre përfitimeve ndihmon në justifikimin e projektit.

7.3 Përfitimet financiare

Në këtë seksion përshkruhen të ardhurat financiare që pritet të gjenerohen nga realizimi i projektit, si rezultat i shfrytëzimit të infrastrukturës ose shërbimeve të krijuara. Këto përfshijnë të ardhurat nga shitjet, tarifat, pagesat e përdoruesve, apo burime të tjera financiare të drejtpërdrejta, që projekti mund të sigurojë gjatë periudhës së operimit. Analiza e përfitimeve financiare ndihmon në vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe në përcaktimin e kohës së kthimit të investimit.

7.4 Ndikimi social

Këtu analizohen ndikimet më të gjera sociale të projektit, përfshirë ndryshimet në mirëqenien sociale, ndryshimet demografike, përmirësimin e edukimit, shëndetit dhe sigurisë, si dhe ndonjë ndikim potencial negativ që mund të kërkojë masa zbutëse. Ky seksion thekson rëndësinë e projektit në transformimin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës së ndikimit.

8. Vlerësimi financiar dhe burimet e financimit

8.1 Kosto investimi

Në këtë seksion përshkruhen në mënyrë të detajuar të gjitha kostot që lidhen me realizimin e projektit, duke përfshirë koston fillestare të investimit dhe shpenzimet që do të lindin gjatë periudhës së zbatimit dhe funksionimit të projektit.



Kostoja fillestare përfshin blerjen e tokës, ndërtimin e infrastrukturës, pajisjet teknike, shpenzimet për projektimin dhe menaxhimin e projektit. Gjithashtu, konsiderohen kostot e zëvendësimit të aseteve kapitale që mund të lindin gjatë periudhës së funksionimit, për të siguruar që infrastruktura dhe pajisjet të mbeten funksionale dhe të efektshme gjatë gjithë jetës së projektit. Në studimin e fizibilitetit, kostoja totale e investimit duhet të harmonizohet me buxhetin e projektit dhe të reflektojë një vlerësim realist bazuar në studime të detajuara të tregut, analizat e çmimeve dhe përvojat e mëparshme. Kjo pjesë, gjithashtu, përfshin edhe koston e mirëmbajtjes dhe operimit, duke përfshirë edhe shpenzimet e personelit, materialeve dhe shërbimeve të tjera të nevojshme për funksionimin e projektit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

8.2 Burimet e financimit

Ky kapitull fokusohet në identifikimin dhe analizën e burimeve të ndryshme të financimit që do të mbulojnë kostot totale të investimit dhe shpenzimet operative gjatë jetës së projektit. Burimet e financimit mund të përfshijnë fonde të buxhetit të shtetit, fonde grant të dedikuara nga institucionet ndërkombëtare, investime private, në kuadër të partneriteteve publike-private (PPP), si dhe kredi. Secili burim duhet të përshkruhet në detaje, duke specifikuar kushtet financiare, afatet e pagimit etj. Gjithashtu, është e rëndësishme të analizohet ndikimi i strukturës së financimit në qëndrueshmërinë financiare të projektit, duke marrë parasysh qëndrueshmërinë e flukseve monetare dhe rrezikun e normave të interesit, kursit të këmbimit etj. Në studimin e fizibilitetit duhet të vlerësohet nëse kombinimi i burimeve financiare është i përshtatshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet dhe për të siguruar një ekuilibër financiar që garanton zbatimin dhe funksionimin e projektit pa ndërprerje.

8.3 Analizë mbi përballueshmërinë

Në këtë pjesë kryhet një analizë e hollësishme për të përcaktuar nëse projektet janë të përballueshme nga perspektiva fiskale dhe financiare gjatë të gjithë ciklit të tyre jetësor. Kjo analizë përfshin vlerësimin e ndikimit neto që do të ketë projektin në buxhetin publik, duke marrë në konsideratë jo vetëm shpenzimet direkte për investimin dhe operacionet, por edhe të ardhurat e mundshme dhe shpenzimet indirekte që mund të shkaktohen nga projektin. Analiza bazohet në modele të fluksit të parasë, ku

krahasohen skenarë të ndryshëm për të parashikuar mënyrën sesi do të menaxhohen mungesat e mundshme të likuiditetit dhe detyrimet financiare gjatë periudhës së investimit dhe operimit. Përballueshmëria është e lidhur ngushtë me qëndrueshmërinë financiare, ku projektin duhet të tregojë se është në gjendje të përballojë kostot e veta, pa shkaktuar presion të tepërt në financat publike apo private. Gjithashtu, në këtë pjesë duhet të adresohen rreziqet e mundshme financiare dhe strategjitë për menaxhimin e tyre, duke përfshirë mundësitë e ristrukturimit të borxhit, burimet shtesë të financimit, apo masat për reduktimin e kostove operative.

9. Vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe klimë

9.1 Rreziqet mjedisore dhe ndikimi klimatik

Në këtë seksion analizohen ndikimet kryesore që projektin mund të ketë në mjedis dhe klimë, përfshirë ndotjen e ajrit, ndotjen e ujit, efektet në tokë dhe biodiversitet, si dhe ndikimet e mundshme akustike dhe vizuale. Vlerësohen, gjithashtu, emetimet e gazeve serrë dhe masat për minimizimin e tyre. Përfshihen rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe adaptimi ndaj tyre gjatë zbatimit të projektit.

9.2 Kërkesat ligjore për ndikimet në mjedis dhe klimë

Ky seksion përmbledh legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar që projektin duhet të respektojë, duke përfshirë ligjet për mbrojtjen e mjedisit, standardet për cilësinë e ajrit dhe ujit, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare për klimën. Përshkruhen edhe procedurat për marrjen e lejeve mjedisore dhe masat për sigurimin e përpunueshmërisë me kërkesat ligjore gjatë zbatimit të projektit.

10. Rreziqet kryesore dhe masat për zbatim

10.1 Rreziqet kryesore

Në këtë seksion identifikohen rreziqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në realizimin dhe funksionimin e projektit, si p.sh.: vonesat në zbatim, ndryshimet ekonomike, probleme teknike, ndikimet mjedisore dhe sociale, apo ndryshimet ligjore dhe politike. Përshkruhen edhe rreziqet financiare dhe ato operationale që mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e projektit.

10.2 Menaxhimi i rreziqeve

Ky seksion përshkruan strategjitë dhe masat që do të ndërmerren për të parandaluar, reduktuar ose eliminuar rreziqet e identifikuar. Përfshihen plane për monitorimin e vazhdueshëm, procedurat për



përgjigje ndaj emergjencave, ndarja e përgjegjëseve dhe përfshirja e aktorëve relevantë. Objektivi është të sigurohet një menaxhim efektiv i rreziqeve gjatë gjithë ciklit të projektit.

11. Plani i zbatimit dhe menaxhimi i Projektit

11.1 Hapat kryesorë të implementimit

Në këtë seksion paraqiten fazat kryesore të zbatimit të projektit, duke përfshirë aktivitetet e planifikuara, afatet kohore dhe pikënisjet për çdo fazë. Këtu përfshihen edhe procedurat për menaxhimin e burimeve dhe monitorimin e progresit.

11.2 Aktorët përgjegjës

Përshkruhen subjektet dhe personat përgjegjës për realizimin e secilës fazë të projektit, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e tyre specifike. Theksohet rëndësia e qartësisë në ndarjen e përgjegjëseve për të siguruar zbatim efikas.

11.3 Koordinimi ndërinstitucional

Ky seksion trajton mekanizmat dhe mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në projekt. Përshkruhen kanalet e komunikimit, takimet e rregullta dhe format e shkëmbimit të informacionit për të garantuar koordinim efektiv dhe evitim të pengesave gjatë zbatimit.

12. Konkluzione mbi fizibilitetin e Projektit

Në këtë kapitull përmbledhen rezultatet kryesore nga të gjitha analizat e mëparshme të studimit të fizibilitetit. Paraqitet një vlerësim i përgjithshëm i fizibilitetit të projektit në aspektet teknike, financiare, ekonomike, mjedisore dhe sociale. Theksohet nëse projekti është i realizueshëm dhe i qëndrueshëm duke u bazuar në evidencat dhe të dhënat e mbledhura.

Gjithashtu, ofrohet një rekomandim i qartë për vendimin përfundimtar të vlerësimit të Projektit, duke përfshirë sugjerime për hapa të mëtejshëm ose rishikime të mundshme në rast të identifikimit të sfidave kritike.

Ky kapitull shërben si një udhërrëfyes i përmbledhur për palët vendimmarrëse për të marrë një vendim të informuar dhe të bazuar mbi analizat e kryera.

URDHËR

Nr. 898, datë 18.9.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E MALIT TË ZI

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Malit të Zi në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 907, datë 19.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E KROACISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Bilje*	
Osjecko Baranjska	- Donji Miholjac*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Jagodnjak*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Vukovarsko Srijemska	- Gradište*	
Vukovarsko Srijemska	- Stari Jankovci*	

Vukovarsko Srijemska	-	Trpinja*	
Vukovarsko Srijemska	-	Županja*	
Vukovarsko Srijemska	-	Otok*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit



Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**



a) kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 892, datë 17.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Kroacisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik,

embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 908, datë 19.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ESTONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një



vlere të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Jögeva	Pölsamaa	Pauastvere*
Rapla	Kehtna	Kehtna-Nurme*
Tartu	Mäksa	Sudaste*
Tartu	Tartu	Väägvere*
Tartu	Tähtvere	Ilmatsalu (Alevik)*
Viljandi	Kolga-Jaani	Vissuvere*
Viljandi	Abja	Veskimäe*
Viljandi	Tarvastu	Anikatsi*
Viljandi	Tarvastu	Kannuküla*
Viljandi	Vüüratsi	Mäeltküla*
Pölvä	Valgjärve	Sulaoja*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Estonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin

janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**



a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit

Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të



Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 839, datë 28.8.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Estonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 909, datë 19.9.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Baranya	Szigetvár*	
Borsod-Abaúj-Zemplén	Sátoraljaújhely*	
Somogy	Kadarkút*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve



Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitruka për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo

28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinarë shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe



embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 877, datë 11.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

KËRKESË
Nr. 794/8, datë 18.9.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 206, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë

dytësore, nyja e Milotit””, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 622 720 (gjashtëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “arë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 622 720 (gjashtëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehin nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE PASURITË, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 206, DATË 6.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘PËRFUNDIMI I PUNIMEVE TË MBETURA DHE PLOTËSIMI ME RRUGË DYTËSORE, NYJA E MILOTTIT””

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimet për shpronësim			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sip. e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera lekë		
1	Kujtim Sinan Lule Lindita Besim	Baftjar Baftjar Baftjar Baftjar	Isufi Isufi Tuga Hidri Isufi	3441	5/15	Arë	3.200	2240	278	622,729.00	622,729.00	
Vlera totale paraprake										622,729.00		

**KËRKESË****Nr. 226/11, datë 22.9.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Ndërtimi i terreneve sportive dhe muri rrethues për shkollën ‘Mustafa Greblleshi’ dhe ‘Sandër Prosi’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 62,092,322.50 lekë (gjashtëdhjetë e dy milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e dy pikë pesëdhjetë) lekë, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e

hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Tiranë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit, në lidhje me projektin e sipërcituar, është 62,092,322.50 (gjashtëdhjetë e dy milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e dy pikë pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA E LLOGARITJEVE PARAPRAKE TË PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I TERRENEVE SPORTIVE DHE MURI RRETHUES PËR SHKOLLËN ‘MUSTAFA GREBLLSHI’ DHE ‘SANDËR PROSI’”																				
Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore									Vlerësimet për shpronësim							Shënime (kuftizime hipotekore barrë mbi pasurinë etj.)
													“Truall”			“Ndërtesë”			Vlera totale (lekë)	
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti/ fshati	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sip. truall (m²)	Sip. ndërtesë (m²)	Vol.	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U
1	Shtet			Tiranë	8190	14/599	Trotuar	32	0	0	19	218	2.20	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
2	Shtet			Tiranë	8190	14/598	Shesh	24	0	0	19	217	15.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
3	Roland	Enver	Hysa	Tiranë	8190	14/733	Truall	2046	2046	0	52	7	93.00	33,755.00	3,139,215.00	0.00	0.00	0.00	3,139,215.00	
4	Aleksander	Preng	Bardhi	Tiranë	8190	14/300	Truall	400	400	0	10	218	167.10	33,755.00	5,640,460.50	0.00	0.00	0.00	5,640,460.50	E- Rrëzësimi = 10841600 lekë, mandat arkëtimi datë 20.9.2011 950.
5	Hamdi	Ramiz	Koci	Tiranë	8190	14/309	Truall	422	422	0	12	232	40.40	33,755.00	1,363,702.00	0.00	0.00	0.00	1,363,702.00	
6	Agim Dallëndyshe Fatmir Flutura Gezim Mahmudie Nazmie Reshep Shefki		Balla Balla Balla Balla Balla Balla Balla Balla	Tiranë	8190	14/273	Truall	2850	2850	0	8	227	66.20	33,755.00	2,234,581.00	0.00	0.00	0.00	2,234,581.00	C- Mbi këtë truall pozicionohet ndërtesa me nr. 14/273-nd., vol. 43, f. 71, zk 8190 në pronësi të Fatmir Balla I. leg; D- ka 3 ndërtime pa leje.
7	Lulzim	Mustafa	Balla	Tiranë	8190	14/668	Truall	68	68	0	36	52	60.60	33,755.00	2,045,553.00	0.00	0.00	0.00	2,045,553.00	
8	Zenel	Hasan	Tresa	Tiranë	8190	14/669	Truall	172	172	0	36	53	36.60	33,755.00	1,235,433.00	0.00	0.00	0.00	1,235,433.00	
9	Pranvera Ilir Liljana Arben Suzana Shqije	Fadil Fadil Fadil Fadil Fadil Fadil	Sula Balla Doma Balla Foto Gerollari	Tiranë	8190	14/737	Truall	3533	3533	0	53	113	536.60	33,755.00	18,112,933.00	0.00	0.00	0.00	18,112,933.00	C- Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa 14/730-nd., vol. 50, f. 208, zk 8190 në emër të Mevlan Beut; D- kufizohen veprimet deri në pozicionim hartografik të pjesëve të shatëra unthi korrigim; E- nga kjo pasuri janë bërë 4 transkriptime: 400 m² në emër të Zija Kanj, 1000 m² në emër të Hysni Beut, 800 m² në emër të Alfred Gjoni, 850 m² në emër të Besim Mata, Tiranë, Tiranë, rr. Senatit.
10	Besim	Abdulla	Mata	Tiranë	8190	14/736	Truall	850	850	0	53	112	25.80	33,755.00	870,879.00				870,879.00	E- Nga kjo pasuri janë bërë katër transkriptime: 400 m² në emër të Zija Kanj, 1000 m² në emër të Hysni Beut, 800 m² në emër të Alfred Gjoni, 850 m² në emër të Besim Mata.



11	Dritan	Mehdi	Beti	Tiranë	8190	14/686	Truall	417	417	1329	42	188	27.80	33,755.00	938,389.00	0.00	0.00	0.00	938,389.00	Tiranë, Tiranë, n. Senatium D- Kontratë për vendosje e hipotekës për gëzimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kreditorësh, sipas vlerave të kredisë; E- Leje legalizimi nr. 2623057, datë 16.12.2016, godinë banimi 2-katëshe + 1 kat nëntokë, sip. kat. parë 1329 m ² verandë + shkallë 24.3 m ² , sip. kat. parë 1329 m ² verandë + shkallë 24.3 m ² leje legalizim nr. 2623057, datë 16.12.2016, godinë banimi 2-katëshe+ 1 kat nëntokë, sip. kat. nëntokë 93.2 m ² , sip. kat. përdhe 1329 m ² , sip. kat. parë 1329 m ² .
12	Shitet			Tiranë	8190	14/633	Rrugë	417	0	0	20	2	415.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	D- Kontratë për ndërtim të paligshëm; E- Vendim nr. 1216, datë 20.8.2021, për legalizimin e ndërtimit pa leje objekti banimi 3-katëshe sip. kat. përdhe 143.5 m ² sip. kat. parë 151.7 m ² (verandë + shkallë 10.3) sip. kat. dytë 151.7 m ² (verandë+ shkallë 17.4 m ²) vendim nr. 1216, datë 20.8.2021, për legalizimin e ndërtimit pa leje objekti banimi 3-katëshe sip. kat. përdhe 143.5 m ² , sip. kat. parë 151.7 m ² (verandë + shkallë 10.3), sip. kat. dytë 151.7 m ² (verandë+ shkallë 17.4 m ²)
13	Lulzim	Mustafa	Balla	Tiranë	8190	14/252	Truall	2184	2184	143.5	5	93	397.20	33,755.00	13,407,486.00	0.00	0.00	0.00	13,407,486.00	D- Kontratë për vendosje e hipotekës për gëzimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër
14	Lulzim	Mustafa	Balla	Tiranë	8190	14/672	Truall	3290	3290	0	36	56	214.00	33,755.00	7,223,570.00	0.00	0.00	0.00	7,223,570.00	
15	Besim	Abdulla	Mata	Tiranë	8190	14/272	Truall	400	400	0	8	228	20.30	33,755.00	685,226.50	0.00	0.00	0.00	685,226.50	
16	Arman	Ferdi	Spahiu	Tiranë	8190	14/670	Truall	600	600	0	36	54	38.00	33,755.00	1,282,690.00	0.00	0.00	0.00	1,282,690.00	



																				kredidhënës, sipas vlerave të kredide
17	Alush Hajri	Zeqir Zeqir	Gjorgji Gjorgji	Tiranë	8190	14/311	Truall	466	466	0	13	99	7.70	33,755.00	259,913.50	0.00	0.00	0.00	259,913.50	C- Mbi këtë pasun pozicionohet ndërtesa 14/311-nd, vol. 49, f. 212, 8190 D- Ka 1 ndërtim të paligjshëm.
18	Ajet	-	Gjorgji	Tiranë	8190	14/310	Truall	580	580	0	13	98	48.90	33,755.00	1,650,619.50	0.00	0.00	0.00	1,650,619.50	C-Vendoset hipoteka ligjore në favor të Drejtorisë së Aliaimit D- ka 2 ndërtime të paligjshme.
19	Lulzim	Mustafa	Balla	Tiranë	8190	14/314	Truall	36	36	0	13	164	17.00	33,755.00	573,835.00	0.00	0.00	0.00	573,835.00	C- Mbi këtë truall pozicionohet ndërtesa me nr. 14/365-nd., vol. 44, f. 224, zk 8190, në pronësi të Bajram Noka L leg.
20	Shtet			Tiranë	8190	14/614	Rrugë	533	0	0	19	233	322.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
21	Shtet			Tiranë	8190	14/616	Truall	1480	1480	966	19	235	1455.70	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	E- Shkolle.
22	Bajram	Nuhi	Duraku	Tiranë	8190	14/671	Truall	500	500	0	36	55	42.30	33,755.00	1,427,836.50	0.00	0.00	0.00	1,427,836.50	
TOTALI														4049.40					62,092,322.50	

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Jurisdiksionit të Përgjithshëm Korçë, me vendimin nr. 41-2024-1253 (319), datë 15.4.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Arqile Kristaq Bacu, i datëlindjes 2.3.1969, dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë e kërkueses, shtetases Mariana Abas Selenica.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

